



FAKULTETI I PUBLIK ADMINISTRIMIT DHE SHKENCAVE POLITIKE

STUDIME PASDIPLLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEZA

“PARTICIPIMI I QYTETARËVE NË PROCESIN E POLITIKËBËRJES NË SFERËN PUBLIKE NË R.M”

Kandidatja:

**Lumturije Luma, Syla
Abdullahi**

Mentori:

Prof.Dr. Jonuz

Tetovë Prill 2019

DEKLARATË NDERI

Deklaroj që puna ime në këtë punim është plotësisht origjinale.

Informatat jua të marra nga autorë në ndryshme, botime, publikime apo internet.

Referencat janë të shënuara poshtë këtij punimi që më kanë ndihmuar gjatë punës sime në këtë punim masteri.

ABSTRAKTI

Në këtë punim trajtohen organet shtetërore në Republikën e Maqedonisë Veriore të cilat formulojnë e deri në miratimin e një politikë publike, dhe sa janë qytarët e R Maqedonisë Veriore të përfshirë në këto faza të politikëbërjes, kush janë aktorët që i bëjnë këto politika dhe roli i qytetarit deri te një informate me karakter publik duke iu referuar ligjit për informata me karakter publik.

Politika publike është ajo që qeveria zgjodhi të bëjë ose jo të bëjë. qeveritë bëjnë shumë gjëra.¹

¹ Understanding public policies Thomas R Dye 2008 fq 1

PËRMBATJA

ABSTRAKT.....	I
PËRMBATJA.....	II
Hyrje.....	-1-
I. POLITIKA DHE POLITIKAT PUBLIKE.....	-
3-	
1.1 Teoritë e politikbërjes.....	-3-
1.2 Përkufizimet e politikave publike.....	-
7-	
1.3 Politika si veprimtari publike.....	-
9-	
II. AKTORËT E POLITIKAVE PUBLIKE.....	-11-
2.1 Aktoret instuticional: Qeveria, Parlamenti, Admininistrata dhe aktorët e rinj institucional.....	-11-
2.2 Aktoret joinstitucional: Partitë, Ekspertet, Subjektet private mbajtëse të interesave specifike.....	-22-
2.3 Kategorotë e politikës publike.....	-25-
2.4 Shteti dhe pushteti.....	-26-
2.5 Format e qeverisjes.....	-27-
III. PARTICIPIMI I QYTETARËVE NË POLITIKBËRJE.....	-
29-	

3.1 Shqyrtimi i ligjit mbi qasjen e lirë të informatave me karakter publik.....	-29-
3.2 Format e pjesëmarjes së drejtëpërdrejtë të qytetarëve në RMV.....	-32-
3.3 Roli i qytetarëve të Maqedonisë në procesin e vendimarrjes	-33-

IV. SHPALOSJA E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI.....-38-

4.1 Hipotezat e parashtruara.....	-39-
-----------------------------------	------

4.3 Permbledhje.....	-61-
----------------------	------

KONKLuzionET.....	-63-
--------------------------	-------------

REKOMANDIMET.....	-64-
--------------------------	-------------

V. SHTOJCA.....-65-

5.1 Anketa.....	-65-
-----------------	------

BIBLOGRAFIA.....	-68-
-------------------------	-------------

HYRJE

Në këtë punim unë kam bërë një analizë të politokave publike, si fillim janë bazuar në teoritë, përkufizimet dhe politikën si veprimrari publike.

Në kapitullin e dytë jamë bazuar në aktorët se si qeveria i krijon ato, dhe sa qytarët janë të informua dhe sa janë të kycur në këto polititika. Duke I kategorizuar politikat publike duke folur për shtetin dhe pushtetin dhe format e qyverisjes.

Në kapitullin e tretë I kamë bërë një shqyrtim ligjit biqasje të informatav e me karakter public që du ju mundësoj qytetarëve më lehtë se si të arrijnë deri te një informatë me karakter publik, duke për kërkesë e derite marrja e përgjigjes së asaj informate me karakter publik, gjithsshtu në këtë kapitull si shembull kamë krahasuar Projektin “Shkupi 2014”, sa qytarët janë të kënaquar dhe a kanë marrë pjesë në hartimin e këtij projekti dhe cka bëhet sot me projektin “Shkupi 2014”. Po ashtu kamë sqaruar se si qytetatët mund të marrin iniciativë për referendum.

Në kapitullin e fundidt kamë shpalosur rezultate e anketës ku nga kjo anketë e realizuar në nivel lokal janë kamë dhënë rekomandimet e mia.

2.LËNDA E HULUMTIMIT

Procesi i politikbërbës në sferën publike luan rol të rëndësisishën sepse përbëhet nga rezultatet e procesit publik. Politikbërja ka të bëjë me vendimarrjen.

Procesi i politikbërjes lidhet direkt me qytetarët në realizimit e interesave të tyre, qëllimi qëndron në indentifikimin e metodave më të mira që instuticionet duhet t'i ndërmarin që qytetarët të jenë të informuar.

Nëpërmjet participimit qytetarët do të komtribojnë në hartimin e strategjive, ku qytetarët do të jenë të kënaqur nga shërbimet që do t'iu ofrohen si dhe do të jenë faktor kyç në planifikimin e qëndrueshëm të strategjive lidhur me politikat publike.

Punimi im ndahet në katër kapituj.

Në kapitullin e parë do të përfshijë teoritë e ndryshme të politikologëve dhe ekspertëve lidhur me politikat publike.

Kapitulli i dytë ka të bëjë me aktorët kryesor që i bëjnë këto politika dhe si ato i aplikojnë dhe i zbatojnë në praktikë.

Kapitulli i tretë do të analizojë se sa qytetarët janë të përfshirë në politikbërje.

Në kapitullin e katërt pra, në të fundit do të analizohen anketat në nivel lokal dhe intervistat me të punësuarit në institucionet shtetërore dhe do të jepen konkluzione dhe rekomandime konkrete.

3.QËLLIMET E HULUMTIMIT

Qëlliimi im në këtë punim do të jetë që sa do pak të mundohem që të ngris vetëdijen e qytetarëve se si dhe sa ata mund të jenë të përfshirë në procesin e politikbërjes, si të arrijnë deri te informatat që kanë nevojë etj.

Qytetarët duhet të jenë të informuar për çdo lloj informate me karakter publik ku qëllimi im kryesor është që të mundohem që nëpërmjet këtij punimi t'ua bëjë sa më të qartë qytetarëve se si të kenë qasje deri te informatat relevante.

Nëpërmjet këtij punimi do të analizojë se sa institucionet shtetërore, qeveria janë transparente ndaj qytetarëve, dhe si të gjejnë një rrugë lidhëse se si qytetarët dhe administrata të kominikojnë për sferat publike.

3. RËNDËSIA E PUNIMIT

Hulumtimi im do ketë një rëndësi si për qytetarët, politikbërsit, institucionet shtetërore, organizatat joqeveritare etj.

Qytetarët do të vetëdisohen që zëri i tyre të dëgjohet dhe të marrin pjesë në krijimin e politikave publike në çdo sferë.

Qytetarët do të jenë të kënaqur kur do të jenë të informuar, për çështjet që i tangojnë ata, njëkohësisht institucionet shtetërore do të jenë më të përgjegjshme në punën e tyre dhe informatat me karakter publik në këtë segment.

I. POLITIKA DHE POLITIKAT PUBLIKE

1.1 Teoritë e politikëbërjes

Shumë studiues të shkencave sociale i definojnë teoritë në mënyra të ndryshme. Teoritë diskutojnë botën që i takon qeverisjes, politikës dhe politikës publike dhe ato sigurojnë konceptet gjuhën lehtësuese të komunikimit me të tjerët për këto tema. Ato gjithashtu ndihmojnë në përqendrimin e vëmendjes së njerëzve në faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë vendimmarrjen e qeverisë.

Autori Michael E Kraft dhe Scott R Furlong i ndajnë teoritë e politikave në katër grupe edhe atë: Teoria elitare: teoria e grupeve;

Teoria elitare

Politika Elitare Teoria e krijimit të politikave që thekson se si vlerat dhe preferencat e elitave qeverisëse, të cilat ndryshojnë nga ato të publikut në përgjithësi, ndikojnë në zhvillimin e politikave publike.

Ne mund të shohim aplikimin e teorisë së elitës duke shikuar te ato që dominojnë në vendimarrjen e politikës publike. Një elitë fuqishme ose e krijuar ëshërë e rallë në qendër të të gjitha vendimeve të politikave, sepse elitat e tjera tentojnë të dominojnë në fusha të tjera të politikave. Për shembull, një elitë mund të ketë ndikim në politikën e huaj, një tjetër në politikën

e mbrojtjes, dhe në fusha të tjera të ndryshme si kujdesi shëndetësor, bujqësia, rregullimi financiar, energjia dhe arsim.²

Elita paraqet një grup njerëzish që njeh veten si superior dhe që ka ndikim dhe komtroll në një pjesë ose në tërë shoqërinë. Ekziston dallimi në mes të elitës politike dhe klasës politike. Në gjysmen e dytë të shekullit XIX, sociologët e mirënjohur si “elitist” Vilfredo Pareto dhe Gaetano Mosca e kanë trajtuar elitën si pjesë përbërëse dhe të pandarë të cdo sistemi politik.

Teoria e elitave është teori provakative për atë se si krijohet politika. Kjo qasje teorika e fukoson kujdesin tonë në rolin e udhëheqjes në procesin e krijimit të politikës dhe në faktin se në të gjitha sistemet politike pakica udhëheq shumicën³

Teoria e grupit

Teoria e grupeve e politikave e sheh politikën publike si produkt i një lufte të vazhdueshme midis grupeve të interesave të organizuara. Kur njerëzit flasin për “interesa speciale” ndikojnë në vendimet e qeverisë, ato përdorin koncepte nga teoria grupeve. Shembuj që mund të marrin përpjekjet të muzikës së incizuar që ta mrojë të drejtën e kopjimit që të bëjë restriksione në internet për akses në muzikën mp3, edhe nga industria e ushqimit që të ndalojë qeverinë të kërkojë detale për procesin e prodhimit të ushqimit, një aksion shumë kohë favorizohet nga grupet e konsumatorëve, sidomos nga shqetësimet në ritje mbi obezitetin e të rriturëve dhe fëmijëve në vend. Disa student të politikave publike argumentojnë tendencat e teorisë së grupeve për të ekzagjeruar rolin dhe ndikimin e interesit të organizuar në hartimin e politikave dhe të nënkuptojnë udhëheqjen e zyrtarëve publikë dhe lirinë e konsiderueshme që ata kanë në bërjen e zgjedhjeve të politikave. është e lehtë të besosh se duke u fshehur çdo vendim i politikës është një grup i veçantë i interesit që dëshiron të ketë rrugën e vet, por fuqia e grupeve të organizuara mundohen të thjeshtësojnë më shumë dinamikë e plotë në politikëbërje. Zyrtarët

² Micheal E Kraft Scott R furlong, Public policy, SHBA fq 82

³ Jonuz Abdullahi, Politika dhe politikat publike, Tetovë 2016 fq 208-209

publikë gjithashtu shpesh përdorin grupe të organizuara të interes për të promovuar agjendat e tyre politike dhe për të ndërtuar mbështetje për iniciativat e politikave.⁴

Teoria institucionale

Teoria institucionale thekson aspektet formale dhe ligjore të strukturave qeveritare. Modelet institucionale shqyrtojnë mënyrën se si qeveritë janë rregulluar, fuqitë e tyre ligjore dhe rregullat e tyre për vendimmarrje.

Termi institucioni mund të ketë shumë kuptime. Ajo i referohet "të dyja organizatave dhe rregullave që përdoren për të strukturuar modelet e ndërveprimit brenda dhe jashtë organizatave". Analistët përdorin teorinë institucionale për të studiuar se si këto shënime të ndryshme kryejnë në procesin e bërjes së politikave, si dhe rregullat, normat dhe strategjitë e përdorura nga individët që veprojnë brenda organizatave të veçanta, siç është Kongresi i SHBA-ve ose sistemi gjyqësor federal. Megjithëse analiza institucionale formale mund të bëhet mjaft komplekse, teoria institucionale është një kujtesë e thjeshtë se rregullat procedurale dhe aspekte të caktuara të strukturës qeveritare mund të fuqizojnë ose pengojnë interesat politike.⁵

Teoria racionale e zgjedhjes

Teoria racionale e zgjedhjes, e quajtur edhe zgjedhja publike dhe teoria formale, draektë shumë nga ekonomia, veçanërisht teoria mikroekonomike dhe shpesh përdor modele matematikore të përpunuara.

⁴ Michael E. Kraft, Scott R. Furlong, Public Policy: Politics, Analysis, and Alternatives, 4th Edition, Kaliforni , 2012 fq 83-85

⁵ Michael E. Kraft, Scott R. Furlong, Public Policy: Politics, Analysis, and Alternatives, 4th Edition, Kaliforni , 2012 fq 81

Teoria e zgjedhjes së rregullit përpiket të shpjegojë politikën publike në lidhje me veprimet e aktorëve të politikës individuale të vetë-interesuar, atëherë ata janë votues, bashkëpunojnë, lobistët, zyrtarët e agjencive ose ligjvënësit.

Teoria racionale e zgjedhjes siguron depërtim mbi sjelljen politike që mund të ndikojë në hartimin e politikave publike. Është veçanërisht e dobishme për të formuluar parashikimin e zyrtarëve të agjencive të huaja dhe objektet apo objektivat e veprimeve të politikave ka të ngjarë të reagojnë ndaj iniciativave të politikave. Ekonomistët thonë se për të bindur individët që të reduktojnë ndjeshëm konsumin e tyre të karburantit, duhet të marrë një rritje në taksën e benzinës prej 50 cent⁶

d. Teoria e sistemeve politike

Teoria e sistemeve politike është më gjithëpërfshirëse, por edhe e përgjithshme, sesa teoritë e tjera. Ajo thekson se sistemi politik (institucionet dhe aktivitetet e qeverisë) i përgjigjet kërkesave që dalin nga mjedisi i saj, siç janë opinioni publik dhe presionet e grupeve të interesit. Teoria e sistemeve thekson kontekstin më të madh social, ekonomik dhe kulturor në të cilin marrin vendime politike dhe zgjedhje të politikave, si një preferencë e përgjithshme për taksat e kufizuara të qeverisë ose të taksave.

Teoria e sistemeve është një formë zyrtare për të menduar rreth ndërlidhjes së institucioneve dhe aktorëve të politikës dhe rolit të mjedisit më të madh.⁷

Pra Teoria elitare bazohet te një grup elitari zakonisht Qeveria që të vetmit kanë përgjegjësi për vendimet e marra publike. Politikaat publike janë të kontrulluara dhe vlerësohen nga elita qeveritare.

Teoria e grupit është rezultat i luftës dhe konkurrencës midis grupeve të ndryshme në shoqëri. Krijuesit e politikave grupore i përgjigjen kërkesave konkurruese të grupeve me ndikim dhe balancimin e interesave në konflikt në shoqëri Politika është ekuilibri i arritur në konkurrencën e grupit.

⁶ Michael E. Kraft, Scott R. Furlong, Public Policy: Politics, Analysis, and Alternatives, 4th Edition, Kaliforni , 2012 fq 81

⁷ Po aty fq 83-85

Për teorinë institucionale apo instituzionalizmi sic kamë hasur te shumë atotorë bazohet në atë se si qeveritë kanë regullorat ligjet dhe regullat për marrjen e vendimeve të politikave publike.

Teoria racionale thekson se qytetarët përpiqen të maksimizojnë në mënyrë aktive avantazhin e tyre në çdo situatë dhe vazhdimisht përpiqen të minimizojnë humbjet e tyre.

Teoria e sistemeve polike bënë mdështejten apo përkrahë procesin e politikëbërjes dhe procedurave ligjore dhe regullore.

1.2 Përkufizimet e politikave publike

Për politikat ppolitikë publike është shumë i gjerë dhe komplekst.

Politika rjedhë që në kohërat e herëshme ku fjala politikë në grqisht: “politikos ku do të thotë “lidhje me qytetarët”.

Termi i politikës publike e hasim me vonë. Në vazhdim do t'i sqarojmë më gjërësisht. Ai është futur në gjuhën e shkencave politike dhe administrative evropiane në vitet '70 si përkthim fjalë për fjalë i termit “public policy”.

Në bazë të këndvështrimit të shoqërisë dhe të raporteve të saj me politikën, politika mund të ndahet në tre degë, që sipas teminologjisë anglosaksone quhen: politics, policy dhe polity. Me politics nënkuptohen veprimtaritë e partive të ndryshme politike, ose të grupeve të ndryshme për të bërë të mundur marrjen e pushtetit politik. Me *policy* nënkuptohen ligjet ose aktet e tjera juridike të realizuara nga pushteti politik për të menaxhuar *pasurinë publike*. Me polity nënkuptohet konsensusi nga ana e trupit elektorale për pushtetin politik dhe kohezioni ndër-shoqëror i grupeve dhe shtresave të ndryshme. Tre aspektet ndërthuren dhe influencojnë në njëra tjetrën duke realizuar dinamika komplekse socio-politike.⁸

Shumë studius bashkohorë politikat publike i definojnë dhe i trajtojnë në mënyra të ndryshme. Në mesin e tyre veçohet James E. Anderson, studius nga Kolerhi Boston, në SHBA, i cili prezanton një analizëkrahuesë të studiusve të ndryshëm në lidhje me këtë çështje. Autori në fjalë niset nga një definicion i përgjithshëm mbi atë se çka në realitet paraqet politika publike.

⁸ <http://shtetiëeb.org/2012/09/22/cjane-politikat-publike/>

Sipas J. Andersonit, politika në sferën publike në kuptimin e gjërë nënkupton raportin e një institucioni konkret me autorizime publike ndaj çështjeve të ndryshme shoqërore.

Ky definicion është aq i gjërë saqë krijon mëdyshje për atë se çka me të vërtetë është politika e definuar në këtë mënyrë, kjo mund të nënkuptohet në forma të ndryshme.

Në këtë frymë, edhe A.Hejvudi e definon politikën në sferën publike, duke u përqëndruar në rolin e udhëheqësve qeveritarë në procesin e politikëbërjes dhe zbatimin e saj në praktikë. Gjithashtu, edhe studiues të tjerë politikën në sferën publike e paraqesin si një aktivitet, që udhëheqësit vendosin ta bëjnë apo mos e bëjnë. Duke iu afruar sa më tepër thelbit të asaj lidhure me atë çka është objekt i interesimit tonë, ky definicion në mënyrë jo-adekuate paraqet dallimin se çka vendos të bëjë dhe asaj që faktikisht e bën pushteti. “Politika kuptohet më mirë si lidhje mes synimeve, veprimeve dhe rezultateve. Në nivelin e synimeve, politika pasqyrohet në qëndrimin e qeverisë (ç’thotë qeveria se do bëjë). Në nivelin e veprimeve, politika pasqyrohet në sjelljen e qeverisë. Sipas kësaj qasje, politika mund të vlerësohet sipas ndikimit që ka, d.m.th sipas rezultatit se çka në realitet ndodh në mjedisin ku veprojnë aktorët politik të qeverisë. Politika konkrete do të vlerësohet sipas mënyrës në qeverisjen dhe sipas pjesëmarrësve në procesin e politikëbërjes në shoqërinë bashkohore.

Richard Rouse, professor në Universitetin e Aberdinit (Angli) dhe anëtar i Qendës për studime të Politikave Publike, jep udhëzime mbi atë se politika konkrete para se gjithash nënkupton një varg të tërë të aktiviteteve të lidhura ngushtë ose jo në mes vete, si dhe konsekuencat e tyre mbi ata të cilëve politika u dedikohet. Ky definicion është interesant sepse bën një dallim në mes të politikës si tërësi aktiviteteve nga njëra anë dhe vetë vendimit që të veprohet në një mënyrë të caktuar nga ana tjetër. Autori në fjalë, duke e definuar politikën si një tërësi aktiviteteve e veçon atë në procesin e vendimmarjes. Vendimmarja, sipas R.Rous-it është një fazë e politikës publike. Politikologu Karl Frederich (professori gjermano-amerikan dhe studiues politik, politikën e zbatuar e sheh si një varg aktiviteteve të institucionit të autorizuar brenda kufijve të një rrethi të caktuar. Sipas këtij studiuesi, fjala është për të gjitha ato aktivitete të individëve ose grupi të njerëzve me autorizim të veçantë, që mund t’i shkaktojnë pengesa ose t’i ndihmojnë procesit të realizimit të qëllimeve konkrete të politikës publike. Nocionin politikë e zbatuar ose politikëbërje si një varg aktiviteteve, K.Frederich e ndërlidh me përcaktimin e kahjes drejt realizimit të qëllimit të veprimit konkret, domethënë se të gjitha aktivitetet çojnë deri te arritja e qëllimit të dëshiruar. Sido që të jetë politika e zbatuar, para se gjithash, më shumë ka të bëjë me atë që faktikisht

bëhet, sesa me atë që është propozuar apo paramenduar që të bëhet në lidhje me ndonjë punë të caktuar.⁹

Sipas këtyre autorëve që ceka më lartë në librin e profesor Jonuz Adullahu mund të konstaj që politikat publike përvec aspektit të qeverisje kanë të bëjnë edhe në aspekte më të gjëra në shoqëri. Pra politikat publike kanë të bëjnë me zgjidhjen dhe regullimin, mbrojtjen e të drejtave të interes public pra qytetarët. Një system i drejtë i politikave publike vendimarrja dhe politikëbërja ndodhin në një ambient të hapur për publikun. Si për shembull pjesmarrja e qytarëve në vendimet e buxheteve, programeve etj. Pra në kapituj më posht do shohim se si janë të regular politikat publike në Republiken e Maqedonise Veriore.

1.3 Politika si veprimtari publike

Shkenca politike është studimi i politikës, që është, federalizmi, ndarja e pushteteve, kontrollet dhe balancat, shqyrtimi juridik, kompetencat dhe detyrat e Kongresit, presidenti dhe gjykatatve shkenca tradicionale përqendrohet kryesisht në këto rregullime institucionale, si dhe në filozofinë e justifikimit të qeverisë. Shkenca politike është më shumë se një studim i proceseve politike, dmth. Fushatat dhe zgjedhjet, votimi, mbajtja e legjislacionit dhe vendimmarrja. Sjellja “moderne” ku shkenca politike përqendrohet më shumë në këto procese.

Shkenca politike është gjithashtu studimi i politikës publike dhe përshkrimi i veprimtarisë së qeverisë. Ky fokus përfshin përmbajtjen e politikës publike; një analizë të ndikimit të forcave sociale, ekonomike dhe politike në përmbajtjen e politikës publike; për të adresuar ndikimin e aranzhimeve të ndryshme institucionale dhe proceseve politike në politikat publike; dhe në vlerësimin e aktivitetit të politikave publike në shoqëri, si të priturat dhe të papritura.¹⁰

Politika publike na tregon se cka qeveria bënë dhe cfarë num bënë në edukim, shëndetësi, mbrojtje ambient jetësor dhe kështu me rradhë.

Për një politikë publike deri te vendimarrja do duhet të kalohet në disa procese apo faza me qëllim të zgjidhjes së problemeve dhe të regullojnë kualitetin e jetës së qytatarëve.

Procesi i politikës publike:

⁹ Jonuz Abdullai, Politikat dhe politikat publike, fq.175 2010 Tetovë

¹⁰ Thomas R Dye Understanding public policy 2008 fq 3

Identifikimi i problemit: identifikimi i problemit të politikës publike nga demonstrimi nga individët dhe grupet e qeverisë

Agjenda fokusohet në atë se cka në të vështet është problemi publik dhe cka do të vedoset më tej.

Formulimi i politikës publike; Pra nga grupet punues të qeverisë, grupet parlamentare grupe e interes etj.

Legjitimiteti i politikës; pra cila politikë do të zgjedhet miratohet nga parlamenti, presidenti dhe gjykatat.

Implementimi i politikës publike; zbatimi i ppolitikave përmes qeverisë, burokracisë, regullim, dhe tjera aktivitete të agjencive ekzekutive.

Evaluimi i politikës publike nga agjencionet e qeverisë, konsultantët e jashtëm media dhe opinion publik.

II. AKTORËR E POLITIKAVE PUBLIKE

Aktorët e politika publike do të ndahen:

a. **në aktorë institucional** ku bëjnë pjesë qeveria, parlamenti- kuvendi, presidenti, administrata dhe aktorët e rinj institucional dhe,

b. **aktorët jinstitutional** bëjnë pjesë: partitë, ekspertët, subjektet private mbajtës të interesave specifike.

Më gjersësisht për aktorë institucional do të sqarojmë më posht.

2.1 Aktorët institucional: Presidenti, Qeveria, Parlamenti, Administrata dhe aktorët e rinj institucional

Në aktorët institucional i dorës së parë është roli i politikanëve në qeveri dhe në parlament. Të qeverisë do të thotë të bësh politika publike. Burimet e qeverisë janë gjithmonë po ato: fuqia kushtetuese, kontrolli mbi financat publike, informacioni dhe media. Vitet e fundit ka një rritje të ndjeshme të rolit të shefit të ekzekutivit për shkak të ndikimit të ndërvarësisë ekonomike.

Megjithatë zgjidhja e problemeve varet nga kapacitetet e vet qeverisë. Megjithë “rënien” e parlamenteve, në shumë aspekte parlamentet luajnë një rol të rëndësishëm në politikat publike. Kjo varet nga kapaciteti përfaqësues i tyre, nga kontrolli i partive, nga rregullat e brëndëshme të parlamenteve (sidomos kontrolli i qeverisë mbi kalendarin e punimeve dhe procedurat e zbatuara në komisionet parlamentare), nga kapacitetet dhe profesionalizmi i shërbimeve parlamentare. Parlamenti mund të loz një rol të rëndësishëm sidomos në vlerësimin e politikave publike. Gjithçka që vendoset nga politikanët, kalon nëpër “duart” e administratës publike, ose të burokracisë, e cila, sipas ligjit, duhet të jetë neutrale, racionale, legale dhe funksionale. Ka një numër të madh modelesh dhe strukturash të organizimit të saj, të cilat, në parim, vendosin atë lidhje të nevojshme me pushtetin politik. Forca e saj buron nga pushteti legjitim i politikës, ndërsa suksesi i politikave publike varet shumë nga profesionalizmi i administratës. Në procesin e bërjes së politikave është me rëndësi të njihen raportet e bashkëveprimit të administratës me aktorët e tjerë të grupeve të interesit dhe ekspertët e jashtëm, si dhe konfliktet e interesave brënda vetë administratës. Në fazat e ndryshme të procesit të bërjes së politikave gjithmonë e më shumë po rritet roli i organizatave private dhe të shoqërisë civile (grupet e lobbying apo të think tank). Shpesh këto organizma, megjithëse të pavarura, ndërthuren me partitë dhe grupet e interesit; megjithatë ato janë të varura më shumë nga strukturat qeveritare që disponojnë burimet e rëndësishme të financimit. Në këtë kategori futen dhe grupet private mediatike, sidomos ato të televizionit dhe të gazetave. Në realiste, rolet e aktorëve të përmëndur më sipër ndërthuren midis tyre duke formuar sisteme aktorësh, që ndërhyjnë në mënyrë pak a shumë të konsoliduar në procesin e bërjes së politikave publike. Ndikimi i tyre në sistemin politik është gjithmonë dhe më i madh. Sipas disa studjuesve, tre janë modelet e ndërveprimit midis aktorëve të politikave publike: Trekëndëshi i hekurt (Iron triangles) Rrjetet e politikës (Policy Networks) Komunitetet e politikës (Policy communities) Në iron triangles përfshihen tre grupe aktorësh: Komisionet parlamentare, axhensitë administrative qeveritare dhe grupet e interesit. Këta trekëndësja janë të shumtë sepse veprojnë në të gjitha fushat e politikave publike. Qëndrueshmëria e tyre bazohet në kapacitetet reciproke të sejcilit përbërës për arritur synimet e tyre dhe për këtë arsye sejcili kontribuon në funksionalitetin etrekëndëshit në të gjitha fazat e procesit. kopje 47 Modeli i rrjeteve ndryshon nga modeli i trekëndëshit sepse është shumë më pak i strukturuar, ai është më i hapur ndaj pjesmarrsve, por ndërveprimet e tyre janë të rastit dhe episodike. Për këto arsye ndikimi i tyre mund të çoj në politika publike më pak të qëndrueshme dhe jo të kontrollueshme.

Ky model është më i përhapur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në sistemet politike të Europës është formuluar modeli i komuniteteve të politikës (policy communities). Në këtë model aktorët vazhdojnë të jenë të shumtë, si në atë të rrjeteve, por janë gjithmonë të njëjtë. Këto komunitete funksionojnë përmes kontakteve me politikanët, njërzit e administratës, përfaqësuesit e grupeve të interesit si edhe me ekspertët e njohur. Ky ndërveprim varet nga njohjet personale dhe synon në procesin vendmarrës për të arritur një zgjidhje që kënaq interesat reciproke. Ky model është shpesh i ngjashëm me atë të qeverisë së partisë.¹¹

Qeveria

Qeveria e Republikës së Maqedonisë Veriore në bazë të Kushtetutës:

- cakton politikën e zbatimit të ligjeve dhe rregullave të tjera të Kuvendit dhe mban përgjegjësi për zbatimin e tyre;
- propozon ligje, Buxhetin e Republikës dhe rregulla të tjera të cilat i nxjerr Kuvendi;
- propozon planin hapësinor të Republikës;
- propozon vendime për rezervat e Republikës dhe kujdeset për realizmin e tyre;
- miraton urdhëresa dhe rregulla të tjera për zbatimin e ligjeve;
- cakton parimet për organizimin e brendshëm dhe për punën e ministrive dhe organeve të tjera të administratës, orienton dhe bën mbikëqyrje mbi punën e tyre;
- jep mendime për propozim-ligjet dhe rregullat e tjera të cilat Kuvendit ia paraqesin propozuesit e tjerë të autorizuar;
- vendos për njohjen e shteteve dhe qeverive;
- vë marrëdhënie diplomatike dhe konsullore me shtetet e tjera;
- merr vendime për hapjen e përfaqësive diplomatike-konsullore jashtë vendit;
- propozon emërimin e ambasadorëve dhe përfaqësuesve të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit dhe emëron shefat e përfaqësive konsullore;
- propozon Prokuror Publik;

¹¹ www.shteti.org

-bën emëtime dhe shkarkime të bartësve të funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj, dhe

-kryen punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.¹²

Qeveria është organ ekzekutues. Politika publike ka të bëjë me qëllimet, formimet dhe veprimet e përcaktuara të qeverisë, apo autoriteteve publike për çështje të caktuara, si dhe hapat që ndërmerren (ose nuk ndërmerren) për t'i zbatuar dhe arsyetuar këto. Për shkak të aplikimit të metodave, sektorëve dhe çështjeve të ekzaminuara, studimi i politikave publike merr shumë forma nga kaq shumë perspektiva të ndryshme, sa që përmbledhja e pjesëve të saj në një model të përgjithshëm e sistematik mund të jetë një detyrë e pamundur. Pra, sqarimi më përgjithësues dhe më i përhapur se me çka merren studimet e politikave publike, është me atë se çka bënë apo nuk bënë qeveria.¹³

Termi qeveri përshkruan mjetet me të cilat një shoqëri organizohet dhe cakton autoritetin në mënyrë që të arrijnë qëllimet kolektive dhe të ofrojnë përfitime shoqëria në tërësi që ka nevojë. Ndër qëllimet që qeveritë në mbarë botën përpiqen të arrijnë janë prosperiteti ekonomik për kombin, sigurimin e kufijve kombëtarë dhe sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve. Qeveritë gjithashtu ofrojnë përfitime për të qytetarët e tyre. Lloji i përfitimeve të ofruara ndryshon sipas vendit dhe llojit të tyre të veçantë qeveritare, por qeveritë zakonisht ofrojnë gjëra të tilla si arsimi, kujdesi shëndetësor dhe një infrastrukturë për transport. Termi politikë i referohet procesit të fitimit dhe ushtrimit të kontrollit brenda një qeverie me qëllim të vendosjes dhe arritjes së qëllimeve të veçanta, veçanërisht atyre që lidhen me të ndarjen e burimeve brenda një kombi. Ndonjëherë sistemet qeveritare janë të hutuara me sistemet ekonomike. Kjo është për shkak se disa lloje të mendimi politik ose organizata qeveritare janë të lidhura ngushtë ose zhvillohen me lloje të caktuara të ekonomike. Për shembull, sistemi ekonomik i kapitalizmit në Evropën Perëndimore dhe në Amerikën e Veriut të zhvilluara afërsisht në të njëjtën kohë me idetë për republikat demokratike, vetëqeverisjen dhe natyrën drejtat. Në këtë kohë, ideja e lirisë u bë një koncept i rëndësishëm. Sipas John Locke, një anglez filozof politik i shekullit të shtatëmbëdhjetë, të gjithë njerëzit kanë të drejta natyrore për jetën, lirinë dhe pronën. Nga kjo erdhi ideja se njerëzit duhet të jenë të lirë të pranojnë të qeverisen. Në shekullin e tetëmbëdhjetë,

¹² Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Veriore numër 08-4642/1 1991

¹³ http://aa.mk/EBStorage/Files/poglavje07_AL.pdf

në kolonitë e Amerikës së Veriut të Britanisë së Madhe dhe më vonë në Francë, kjo u zhvillua në idenë se njerëzit duhet të qeverisin veten përmes përfaqësuesve të zgjedhur dhe jo një mbreti; vetëm ata përfaqësues të zgjedhur nga populli kishin të drejtë të bënin ligje për t'i qeverisur.¹⁴

Qeveria e Republikës së Maqedonisë Veriore është ajo që i harton politikat publike si psh programet shkollore, Buxhetin, planifikimin hapsinor dhe më pasë i dorëzohen Kuvendit apo Parlamentin për shqyrtim dhe miratim. Pas miratimit të këtyre programeve dhe planneve publike ka për detyrë që t'i zbatojë ato. Më do flasim për projektin Shkupi 2014 nga hartimi e deri te zbatimi I projekti të madh që I kushtoj një kosto shumë të madhe Maqedonisë Veriore.

Parlamenti apo Kuvendi

i Republikës së Maqedonisë Veriore ka këto kompetenca:

- nxjerr dhe ndryshon Kushtetutën;
- nxjerr ligje dhe bën interpretimin autentik të ligjeve;
- i përcakton detyrimet publike;
- nxjerr Buxhetin e Republikës dhe llogarinë përfundimtare të Buxhetit;
- nxjerr planin hapësinor të Republikës;
- ratifikon marrëveshje ndërkombëtare;
- vendos për luftë dhe paqe;
- merr vendim për ndryshimin e kufijve të Republikës;
- merr vendim për aderim dhe dalje nga aleanca ose bashkësia me shtetet e tjera;
- shpall referendum;
- vendos për rezervat e Republikës;
- themelon këshilla;
- zgjedh Qeverinë e Republikës së Maqedonisë;
- zgjedh gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë;
- bën zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve;
- bën zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin edhe të bartësve të tjerë të funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj;

¹⁴ Glen Kruz, American Government Botimi 2016 fq.8

- ushtron kontroll dhe mbikëqyrje politike mbi Qeverinë dhe mbi bartësit e tjerë të funksioneve publike të cilët përgjigjen para Kuvendit;
- jep amnisti, dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Nga kompetencat e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Veriore vlenë të kutohet që Kuvendi ka një rol shumë të rëndësishim në zbatimin e politikave publike që me anë të deputetëve që e përbëjnë ka ndikim direkt në vendimin e politikave publike. Pra Kuvendi I Republikës së Maqedonisë është një organe bartës I pushtetit ligjdhënës.

Presidenti

Në sistemin presidencial presidenti ka autorizime të forta. Në republikën parlamentare presidenti nuk ka më shumë pushtet se monarku parlamentar dhe pushteti i tij faktik është zvogëluar shumë dhe atë në dobi të kryeministrit, ndërsa në sistemet e përziera roli i tij është forcuar. Në sistemin parlamentar (sisteme të bashkuara të pushtetit) shefi i shtetit varet nga kuvendi dhe atij i përgjigjet. Do të thotë, pozita dhe roli politik i shefit të shtetit janë të ndryshme në vende të ndryshme dhe varen nga rregullimi shtetëror dhe tipi i organizimit të pushtetit, por domethënia e këtij institucioni varet edhe nga shumë faktorë të tjerë siç janë: mënyra e të ardhurit në pushtet, përgjegjësia, gjerësia e autorizimeve dhe kështu me radhë.¹⁵

Presidenti i Republikës së Maqedonisë:

- cakton mandatarin për formimin e Qeverisë së Republikës të Maqedonisë;
- emëron dhe revokon me dekret ambasadorët dhe përfaqësuesit e Republikës së Maqedonisë jashtë vendit;
- pranon letrat kredenciale dhe revokuese të përfaqësuesve të huaj diplomatikë;
- propozon dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë;
- propozon dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor Republikan;

¹⁵ http://aa.mk/EBStorage/Files/poglavje07_AL.pdf

- emëron tre anëtarë të Këshillit për Siguri të Republikës së Maqedonisë;
- i propozon anëtarët e Këshillit për Marrëdhënie Ndëretnike;
- emëron dhe shkarkon edhe bartës të tjerë të funksioneve shtetërore dhe publike të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj;
- ndan dekorata dhe mirënjohje në përputhje me ligjin;
- bën faljen në përputhje me ligjin, dhe
- kryen detyra të tjera të përcaktuara me Kushtetutë

Presidenti i Republikës mban përgjegjësi për shkeljen e Kushtetutës dhe të ligjeve gjatë ushtrimit të të drejtave dhe detyrave të tij.

Procedurë për verifikimin e përgjegjësisë së Presidentit të Republikës, ngre Kuvendi me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Për përgjegjësinë e Presidentit vendos Gjykata Kushtetuese me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve.

Nëse Gjykata Kushtetuese e verifikon përgjegjësinë e Presidentit të Republikës, funksioni i pushon me fuqinë e Kushtetutës.¹⁶

Administrata publike

Administrata është një urë lidhëse në mes qytetarëve qeverisë shoqërive civile. Administrata publike në Republikën e Maqedonisë Veriore ndahet në administratë qendrore e cila përbëhet nga ministritë dhe institucionet tjera shtetërore dhe administrata lokale apo vetëqeverisja lokale-kumunat.

Një tipar veçues i shteteve moderne është vendosja e administratës publike, e cila është në parim e hapur për të gjithë qytetarët që i përmbushin kushtet e përshkruara të punës. Administrata është e ndërtuar në atë mënyrë që ka një hierarki të qartë përgjegjësisish dhe detyrash, të përcaktuara me rregulla dhe autoritete të qarta. Vendimet qeveritare rrjedhin në drejtim vertikal, nga organet qeveritare (ministrat ose 95 zyrtarët qendrorë) deri te shërbyesit e administratës që zbatojnë

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Veriore numër 08-4642/1 1991

urdhrrat dhe vendimet. Mirëpo, ka mjaft studiues të cilët konsiderojnë se ‘pushteti’ i vërtetë politikbërës gjendet pikërisht në duar të administratës dhe se është faktikisht ajo që i realizon apo zbaton politikat. Kjo për shkak të organizimit efikas, qëndrueshmërisë si dhe ekspertizës në sektorë përkatës të politikave. Kështu p.sh, kur ndonjë zyrtar i lartë qeveritar sjell vendimin për hartimin e ndonjë politike edhe i ngarkon zyrtarët për këtë detyrë, të cilët kështu bëhen politikbërësit real pa pasur shpeshherë përgjegjësi formale ndaj publikut. Politika publike me këtë dhe në kuptimin aplikativ, është pra edhe ajo çka zyrtarët, shërbyesit civil apo administruesit në fakt zbatojnë në praktikë. Një faktor shumë i rëndësishëm në procesin e politikbërjes është padyshim pra administrata shtetërore e cila është zakonisht adresa ku përfundojnë rregulloret, udhëzimet etj., dhe prej nga fillon formulimi si dhe zbatimi i tyre. Megjithatë është e tepruar të thuhet se administrata publike është faktor i vetëm dhe dominues në politikbërje, por sigurisht është njëra nga ato vende ku përpilohen politikat. Duke pasur parasysh këtu rolin e mekanizmave dhe aktorëve tjerë jozyrtarë dhe ndikimin e tyre në procese të bërjes së politikave. Me administratë kryesisht nënkuptohet koordinimi dhe implementimi i rregullave si dhe shërbimi që i bëhet qytetarëve. Administrata është veprimtari shtetërore, e cila nuk është as ligjvënies as gjyqësi. Ky është një mekanizëm thelbësor i shtetit me të cilin detyrat organizative dhe rregulloret vihen në jetë. Burokracia do të thotë administrim, udhëheqje nga zyra apo pozita më tepër sesa nga një person apo pushteti i ‘trashëguar’. Burokracia, në ‘llojin ideal’ (idealtypisch) sipas Ëeberit, karakterizohet me ndarjen e punës, hierarkinë e autoritetit dhe aktet e shkruara respektivisht dokumentet zyrtare. Parimi i kompetencës është një princip esencial në zhvillimin e administratës, sipas së cilës secili zyrtar apo zyrë punon në bazë të autorizimeve dhe e organizuar në hierarki. Kështu, 97 nëpërmjet aparatit administrativ, që rregullohet sipas kualifikimeve profesionale, pushteti racionalizohet, kurse organizimi i shtetit dhe i shërbimeve të përgjithshme që ofron, bëhen shumë më efikase dhe gjithëpërfshirëse në shoqëri. Ëeberi e përshkruan administratën në përgjithësi si një organizim me rregulla specifike dhe e specializuar në njësi të veçanta dhe detyra të caktuara. Personeli administrativ është i ndarë nga qeveritarët politik. Autoriteti politik është vertikal, i organizuar në një hierarki dhe i rekrutuar nga pozita, merita ose forca politike. Ndërkaq, zyrtarët e administratës zgjedhën zakonisht në formë të hapur, përmes konkurseve dhe në bazë të ekspertizës (përvojës dhe përgatitjes profesionale). Këta të fundit s’janë vendimmarrës, por i zbatojnë vendimet dhe urdhrat e marra nga institucionet shtetërore. Shtatë elementë kyçe të burokracisë sipas Ëeberit janë: Ndarja e punës, autoritetit dhe

përgjegjësisë janë të përcaktuara qartë për secilin dhe janë legjitimuar si detyra zyrtare; Zyrat apo pozicionet janë të organizuar në një hierarki të autoritetit që rezulton në një zinxhir komandues apo parimin shkallor; Të gjithë anëtarët organizativ janë zgjedhur në bazë të kualifikimeve sipas ekzaminimeve formale apo duke u mbështetur në arsimim; Zyrtarët janë të emëruar, nuk zgjidhen (përveç në disa raste të jashtëzakonshme për shembull, të shefit të gjithë njësisë që është zyrtar i zgjedhur publik); Zyrtarët administrativ kanë paga fikse dhe janë zyrtarë të karrierës; Zyrtarët administrativ nuk janë pronarë të njësive që ata administrojnë; Administratorët janë subjekt i rregullave rigoroze, disiplinës dhe kontrollit në lidhje me kryerjen e detyrave të tyre zyrtare. Këto rregulla dhe kontrole janë të përcaktuara dhe zbatohen në mënyrë uniforme në të gjitha rastet dhe nga të gjithë zyrtarët. Një ndarje të burokracisë respektivisht administratës nga politika e kishte propozuar dhe shtjelluar edhe Presidenti i dikurshëm amerikan Ëoodroë Ëillson, në vitin 1887, pra shumë kohë para se të ishte në këtë post. Prandaj administrata e zhveshur nga interesat partiake e politike dhe krejtësisht profesionale nganjëherë quhet edhe uillsoniane. Sipas tij, administrata publike është zbatim i përpiktë dhe sistematik i ligjeve. Politika është për hartimet dhe miratimet e ligjeve (legjislativi) dhe krijimin e politikave (ekzekutivi), ndërsa administrata ka të bëjë me zbatimin e ligjeve dhe politikave në praktikë. Me fjalë të tjera, politika i vendos detyrat administrative, por puna e administratës është përtej qëllimeve të politikës. Leonard D. konsideron se: “Administrata publike konsiston në veprimet që kanë për qëllim zbatimin ose imponimin e politikave publike.” Administrata publike, siç na e 99 bënë me dije edhe Ëeberi, është një mekanizëm shtetëror i cili është ngritë si komponentë qenësorë e procesit të shtetformimit dhe vazhdon të ketë një rol jetik në zbatimin e politikave. Kjo vjen për shumë arsye, së pari administrata vazhdon të ketë një qëndrueshmëri dhe autonomi dhe se ka mundësi dhe aftësi që t’i qaset dhe t’i zbatoj udhëzimet, rregulloret dhe aktet e ndryshme ligjore . Administrata shërben për të jetësuar vet funksionimin e aparatit shtetëror, ajo është pasqyrë e funksionimit apo të mosfunksionimit të secilit shtet. Me fjalë të tjera, administrata publike përben institucionalizimin e shtetit në formën më të spikatur dhe atributin më domethënëse të tij. Administrata publike është një strukturë organizative që paraqet bazën për vendimmarrje dhe zbatimin e vendimeve, rregulla sipas të cilave realizohen shërbimet publike. Administrata duhet të jetë në shërbim të qytetarëve dhe urë lidhëse mes politikës zyrtare dhe publikut. Ajo është vija e parë e frontit ku vendimet e marra nga politika duhet të vihen në jetë. Funksionimi i shtetit dhe efikasiteti i politikave nga ana e qeverisë varen nga një administratë

profesionale, e përgjegjshme dhe e pavarur nga ndikimet e jashtme. Tash, gati një shekull pas diskutimeve e studimeve fillestare rreth administratës dhe qeverisjes, gjeturat e të cilave janë zbatuar te një pjesë e konsiderueshme e administratës të shumë shteteve. Tani me zhvillimet e hatashme teknologjike sikurse dhe transformimeve shoqërore, mjaft vende janë duke aplikuar gjerësisht të ashtuquajturën administratën elektronike 100 ose edhe ‘e-qeverisje’ (pra administrim dhe shërbime administrative qytetarëve përmes teknologjisë informative). Me zhvillimet bashkëkohore edhe administrata shtetërore merr formë dhe funksion të ri në ofrimin e shërbimeve, rritjen e performancës si dhe ngritjen e efikasitetit. Kështu, reformat në administratën publike zakonisht shkojnë në përputhje me zhvillimet e reja, duke iu përshtatur dhe shfrytëzuar mundësitë që ofrojnë këto zhvillime.¹⁷

Aktorët e rinj intuiticional (gjykatat kushtetuese dhe autoritetet rregullatore)

Gjykatat

Ndikimi i gjyqtarëve në interpretimin e ligjeve ka një ndikim po aq të rëndësishëm në politikë. Vendimi i Bordit të Arsimit Broën kundër Topekës në 1955, për shembull, filloi politikat e antisegregacionit dhe veprimi si katalizator për të drejtat e votimit aktet e viteve 1960 dhe politikat e të drejtave civile përmes vitet 1980. Në mënyrë të ngjashme, vendimi i vitit 1973 Roe v. Ëade më pas përcaktoi praktikisht politikat e abortit.

Por, ndikimi i politikës gjyqësore nuk është i kufizuar Vendimet e Gjykatës Supreme. Laërence Baum dhe Gerald Rosenberg kanë pikëpamje të ndryshme për këtë.²⁰ Baum thekson se gjykatat e apelit janë të rëndësishme, nëse shpesh injorohen, partnerë në krijimin e politikave. Gjykatat e apelit kanë pasur ndikim kritik në disa fusha, duke përfshirë abortin dhe civilin politikave të të drejtave. Rosenberg vëren se, pavarësisht nga ndikimin e rëndë të Broën ose Roe, në shumë vendimet e gjykatave kanë pasur shumë pak ndikim politik. Roli i politikave të gjyqësorit nuk vlerësohet në mënyrë universale. Debati aktual mbi aktivizmi gjyqësor dhe përmbajtja gjyqësore

¹⁷ Bekim Baliqi, politika publike dhe qeverisja 2017 fq 94

është vetëm më të fundit në një diskurs të gjatë. Në "Drejt një Gjyqësori Imperial" ²¹. Nathan Glazer argumenton këtë aktivizmi gjyqësor cënon politikën demokratike institucioneve, dhe që një gjykatë aktiviste të dëmtonte respekti dhe besimi i njerëzve për gjyqësinë. Megjithatë, nëse një gjykatë është aktive ose pasive, ka implikime të rëndësishme të politikave. Derisa vendimi i Broën mund të konsiderohet "aktivist", për shembull, nëse gjykata ka zgjedhur të mbetet pasiv, politika e të drejtave civile mund të ketë mbetur nuk ekzistojnë për shumë vite të tjera. Nonaction është në vetvete një vendim politikash me politikë substanciale implikimet. ¹⁸

Gjyqësori në Republikën e Maqedonisë është organi ipavarur. Gjykat në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Gjykata themelore, gjykata e apelit, gjykata kushtetuese gjykata administrative dhe gjykata kushtetuese.

Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës e të ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën. Organizimi i gjyqësisë është unik. Ndalohen gjykatat e jashtëzakonshme. Llojet, kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si dhe procedura para tyre, rregullohen me ligj, i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. ¹⁹

2.2 Aktoret joinstitutional: Partitë, grupet e interesit, shoqëria civile

Partitë

Partitë politike zënë një vend shumë të rëndësishëm në sistemin politik të një vendi duke qene si garantuese të funksionimit të demokracisë ku nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe demokratike garojnë për të fituar besimin e elektorate për përfaqësimin e tyre në ushtrimin e pushtetit ekzekutiv. Jo të gjithë grupimet politike janë parti. Në të vërtetë, kemi të bëjmë me grupe politike atëherë kur egziston një [ushtet për t'u marrë dhe për t'u ushtruar. Dhe kjo për arsyen e qartë që një veprim bashkërenditës është më i dibishëm sesa një bashkërendim i veprimeve individuale. Në politikë, ashtu si edhe në luftë, një ushtri e madhe, një komandim i kthejllët , një një disiplinë e vërtetë ,e janë gjithmonë kushtet të dosmosdoshme për arritjen efektshmërisë. Por

¹⁸ Public Policy: The Essential Readings, 2nd Edition faqe 203 StSella Z. Theodoulou, Matthee A. Cahn California

¹⁹ Kushtetuta e Replikës së Maqedonisë Veriore numër 08-4642/1 1991

koncepti i partisë është kufizues. Partitë, në kuptimin që ne nënkuptojmë, jnaë shfaqur në përfundim në shekullin xix. Ato përbënin një risi. Edhe pse partitë rivunë në përdorim një numër të caktuar mekanizmash politike dhe sociale paraezistuese, ato zotërojnë tipare krejt të vecanta: janë të institucionalizara; kërkojnë një mbështetje popullore; dallohen në mënyrë të pastër nga grupet e ndikimit.²⁰

Grupet e interesit

Grupet e interesit janë një partner themelor në marrjen e politikave. Qytetarët marrin pjesë në këtë politikë përmes komunikimit me politikëbërësit. Një komunikim i tillë zhvillohet individualisht (p.sh. letra për përfaqësuesit e zgjedhur) dhe kolektivisht. Grupet e interesit lehtësojnë kolektimin komunikimit. James Madison e njohu prirje për individët të fraksionojnë në një përpjekje për të maksimizuar ndikimin politik. Robert Dahl përsosi më tej analizën e Madisonian demokracisë, duke argumentuar se në një shoqëri të hapur të gjithë personat kanë të drejtë të shtypin interesat e tyre. Në masën që të tjerët ndajnë këto interesa, presioni kolektiv mund të lejojë ndikim më të madh politik. Në të vërtetë, Dahl argumentoi, ato çështje që kanë përparësi më të madhe të kenë grup më të madh interesash në përfaqësim. Megjithatë, dinamika e grupit të interesit është jo aq e thjeshtë. Ndërsa mund të jetë e vërtetë se shumë Çështjet e spikatur kanë përfaqësim të grupit të interesit, forca e asaj përfaqësimi është jo e lidhur me forcën e çështjes së çështjes. Për më tepër, vetë spikatja mund të jetë pasojë e veprimeve të grupit të interesit. Kur studion rezultatet e politikave, është e nevojshme të identifikohen aktorët politikë dhe burimet politike të tyre përdorur. Maksimizimi i politikave kërkon politika specifike burime. Burimet më të zakonshme përfshijnë njohuri burokratike, një rrjet kontaktesh, mbështetja e qytetarëve (madhësia e zonës së votimit), një aftësi për të dhënë kontribute politike dhe aftësi për të ngritur një fushatë të marrëdhënieve me publikun (media). Është e qartë se asnjë grup nuk shfrytëzon të gjitha këto burime. Por aftësia e një grupi të organizuar për t'u përdorur një ose më shumë nga këto burime janë kritike ndikim politik. Modeli pluralist i

²⁰ Hyrje në shkencat politike jean-marie denquin fq 83

kundërbalancimit elitat që ndërmjetësojnë interesat janë të pamjaftueshme. Puna teorike e bërë nga Mills dhe puna empirike bërë nga Schattschneider, Domhoff dhe Presthus, ndër të tjera, sugjerojnë se në vend që të konkurrojnë, interesat e elitave ekonomike tentojnë të bashkohen fushat kryesore të politikës.³¹ Loëi's The End of Liberalism³² argumenton se ky ndikim i grupit të interesit kërcënon baza demokratike e qeverisë. Nëse interesi grupet sigurojnë kornizën për qeverisjen, ndërveprimi i qytetarëve, dhe këto grupe janë të bazuara interes vetjak individual, ka pak mundësi. Për ndjekjen e një interesi kuptimplotë kombëtar. Jo vetëm grupet e interesit të korporatave dhe PACs në një kohë të gjithë të lartë, por struktura e krijimi i politikave ka ardhur për të pranuar institutet private mendore si institucione demokratike. Instituti Brookings, RAND Corporation, Këshilli për Zhvillimi Ekonomik (CED), Këshilli i Jashtëm Marrëdhëniet (CFR), dhe të tjerët formojnë një urë midis interesat e korporatave dhe qeveria. Mendoni tanke konsiderohen nga shumë krijues të politikave konsulentët e politikës neutrale dhe kështu vazhdoen qasje e madhe në arenën e krijimit të politikave. Megjithatë, pothuajse të gjithë ata kanë themele të forta në komunitetit të korporatave. Korporata RAND ishte krijuar si një sipërmarrje e përbashkët midis Forcave Ajrore të SHBA dhe industria e hapësirës ajrore si një think tank kushtua.²¹

Shoqëria civile

Nevojitet një bashkëpunim i gjerë prej shumë faktorëve dhe aktorëve të ndryshëm në mënyrë që të garantohet paanshmëria dhe efektiviteti në procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes. Në këtë kontekst, shoqëria civile shihet me të drejtë si kontribuues i çmueshëm i interesave të qytetarëve. Edhe pse historiku i shoqërisë civile është shumë më i hershëm, zhvillimi i konceptit të shoqërisë civile bashkëkohore ishte i theksuar, sidomos në fund të viteve 1960-ta dhe gjatë viteve 1970 në Evropën perëndimore dhe ShBA, kur u krijuan lëvizje shoqërore e politike, që sfidonin pushtetin dhe promovonin një kulturë të re qytetare e demokratike. Sa i përket pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën politike, përveç votimit në zgjedhje të lira, ekzistojnë edhe

²¹ Public Policy: The Essential Readings, 2nd Edition faqe 203 StSella Z. Theodoulou, Mattheë A. Cahn California

aktivitete tjera si angazhimi në subjekte politike, fushata zgjedhore, në protesta, demonstrata, peticione, referendume, shkresa publike, kërkesa ndaj zyrtarëve, kontakte me qeveritarët, angazhime për çështje të ndryshme publike në komunitet etj. Një sistem i lirë dhe demokratik nuk mund të jetë asnjëherë vërtetë i tillë nëse nuk ka qytetari aktive. Kjo nënkupton që vetëdija dhe angazhimi i qytetarëve në jetën politike nuk kufizohet vetëm në pjesëmarrje në zgjedhje, por në tërë procesin e politikbërjes, duke i mbrojtur të drejtat dhe interesat e veta dhe të komunitetit të vet aktivisht. Në politikat publike duhet vënë në pah përherë shoqërinë civile si palë mjaft e rëndësishme dhe faktor kyç që kontribuon në procesin e politikbërjes. Në arenën ndërkombëtare janë mjaft organizata joqeveritare që kanë demonstruar ndikim të jashtëzakonshëm në promovimin dhe ndikimin e vlerave të mirëfillta demokratike apo në mbrojtje të kauzave të caktuara, siç është rasti më ilustrues me të drejtat e njeriut ose me mbrojtjen kundër ngrohjes globale. Roli i organizatave dhe institucioneve të tilla si në rrafshin global ashtu edhe në atë nacional e lokal, duket që të jetë gjithnjë e më i rëndësishëm si një urë lidhëse mes qytetarëve dhe qeveritarëve. Prandaj në studimin e politikave rëndësishme të shoqërisë civile në përgjithësi dhe veçanërisht i OJQ-ve duhet t'i kushtohet një vëmendje e posaçme.²²

Veprimi i OJQ- mund të analizohet në tri nivele të ndryshme: mikro-politikave, makro-politikave dhe vendosjen e normave. Zyrtaret pranonë se konsultimi me OJQ të i bënë vendimet e tyre publike dhe me shumë kredibilitet.²³

OJQ-të shtrirë mund të fragmentojnë dhe të dobësojnë veprimet politike në bazë, nga duke kanalizuar shqetësimet në lobimin e "grupit të interesit" të ngushtë dhe shpesh konkurrent. Ata që kryejnë shërbime sociale mund të jenë një pjesë e padëshirueshme e neoliberalizmit sulm ndaj shtetit, ose (në rastin më të mirë) një përgjigje e dëshpëruar dhe e papërshtatshme ndaj largimi i shtetit nga mbrojtja sociale. Në një përpjekje për të mbijetuar dhe për të ofruar shërbime për nevojat në rritje, ato mund të nxisin shpresat e rreme, të promovojnë pragmatizëm të gabuar dhe të bllokojnë kuptimin më fundamental dhe kritik të rrënjëve të shoqërisë në krizë.²⁴

²² https://www.academia.edu/35514598/POLITIKAT_PUBLIKE_DHE_QEVERISJA

²³ James A. Paul, NGOs and Global policy-making Global policy forum 2000

²⁴ Po aty

2.3 Kategorotë e politikës publike

Ekzistojnë shumë politika publike, ku cdo autorë i klasifikon ato dhe i kategorizonë. Autori Meirer Kenneth, ka bërë ndarjen e vetë edhe atë: politika regulluese, shpërndarëse, rishpërndarëse dhe tërësore.

1.**Politika regulluese** paraqesin atë loj të politikave publike nëpërmjet të cilave janë kufizuar veprimet e personave apo grupeve, për të mbrojtur publikun e gjërë apo një pjesë të qytetarëve.²⁵

2.**Politikat shpërndarëse**, janë nga format më të përhapura në mesin e politikave qeveritare. Ky lloj i politikave publike shërben për të përdorur të ardhurat nga taksat për të krijuar përfitime për individët ose grupe të caktuara, shpesh nëpërmjet dhënjes së granteve ose subvencioneve. Këto lloje të politikave përdoren në sfera të ndryshme të jetës dhe veprimtarisë qeverive, si p.sh ndarja e subvencioneve për bujqit për prodhimin e kulturave bujqësore.

3. **Politikat rishpërndarëse**, janë ai lloji i politikave publike, nëpërmjet të cilave bëhet grumbullimi i të ardhurave nga taksapaguesit d.m.th marrja e mjeteve të grumbulluara nga qytetarët që kanë gjendje të mirë Maqedonisë është ekonomike dhe një dedikim deri te shfrytëzuesit e ndryshëm që janë në gjendje të palakmueshme si nevojtarë dhe raste sociale. Politikat rishpërndarëse, Maqedonia është shtet social që dhe i përdor këto politika, pra politikën rishpërndarëse nëpërmjet programve të ndryshme të ministrisë për punë dhe politikë sociale.

4.**Politika tërësore** janë politika publike, të cilat synojnë arritjen e përfitimeve për publikin e gjërë ose për t'i shërbyer qeverisë. Në republikën e Maqedonisë, politikat tërësore i bëjnë agjencitë qeveritare ku kanë për qëllim të kryejnë shërbime dhe veprimtari të përgjithshme, si p.sh Agjencia për zbulim dhe kundërzbulim, Agjencia për menaxhimin me kriza, Agjencia për mbrojtjen e ambientit jetësor etj..²⁶

²⁶ Jonuz Abdullai, Politikat dhe politikat publike, fq.183, 2010 Tetovë

2.4 Shteti dhe pushteti

Përdorimi i termit shtet filloi në shekullin XVII, pas daljes së botimit të Botoros Region di Stato më 1589. Fjala nisi të qarkullojë si term politik, duke bashkëjetuar gjithmonë e më pak me termin res publica (me shoqërinë e organizuar politikisht si një e tërë e vetme) dhe të njëjësohet me strukturat e komandimit (pushtetin, dhunën), që i vënë kufizime shoqërisë nëpërmjet një autoriteti public final për çdo territory të dhënë.²⁷

Pushteti si kategori shoqërore dhe politike paraqitet me paraqitjen e njeriut, që do të thotë se atje ku ka njerëz modoemos të ketë pushtet. Pushteti, nga spektri politik mund të definohet si një forcë, e cila buron nga populli dhe forcë e tjetërsuar (nga populli).²⁸

Pushteti në të shumtën e rasteve nënkupton përdorimin e detyrimit, shtrëngimit, sanksioneve deri në përdorimin e forcës. Por mjete të tilla nuk janë të gjitha të dhunshme ose të mbështetura vetëm mbi forcën ushtarake apo sanksione ekonomike. Psh, zbatimi i ligjeve është i detyrueshëm, por kjo nuk do të thotë që për t'i zbatuar ato të përdoret vazhdimisht dhuna. Në shoqëritë demokratike, njerëzit ndërgjegjsohen për ligjet dhe veprimtarinë e tyre e organizojnë dhe drejojnë në përputhje me to. Shtrëngimi përdoret për shkellësit e ligjeve, të cilët i nënshtrohen ndëshkimit me dënime juridike përkatëse.

Idelogjia marksiste-leniniste e identifikon pushtetin si mjet dhune me shtetin.²⁹

Sipas Max Weberit ekzistojnë tre lloje të legjimitetit:

(në familje kryetari I familjes ka sunduar gjithnjë),

1. Legjimiteti tradicional (në familje kryetari i familjes ka sunduar gjithnjë),
2. I dyti është legjimiteti karismatik, që mbështetet në dedikimin e karakterit të shënjtë ose në forcën heroike ose në vlerën e veçantë të një personi. Lideri ka një mision dhe ata që qeverisen janë të bindur se është kështu. Ky është rasti i Cezarit dhe Napoleonit, edhe rasti i Hitlerit, Mussolinit, Leninit dhe Stalinit. Ky tip i pushtetit shkon në mënyrë të paevitueshme drejt zhgënjimit në momentin kur misioni i liderit dështon ose me vdekjen

²⁷ Edhe njëherë për Teorinë e Demokracisë, vëll. II. Giovanni Sartori, Tiranë 1992 fq.295

²⁸ Jonuz Abdullai, Politikat dhe politikat publike, fq.62, 2010 Tetovë

²⁹ Lambro Filo, Sistemet politike bashkëkohore, fq 22, Tiranë

e liderit. Në disa raste megjithatë pushteti karismatik mund të jetë institucionalizuar: rasti i Perandorisë romake të krijuar prej Cezarit dhe e Bashkimit Sovjetik të krijuar nga Lenini.

3. I treti është legjitimiteti ligjor–racional, që mbështetet mbi besimin në legjitimitetin e rregullimeve statutore (për shëmbull, kushtetutat) dhe mbi të drejtën e drejtimit të individeve të zgjedhur nga populli për të qeverisur. Kjo është një legjitimitet modern, demokratik dhe impersonal.³⁰

Pra shteti ka kuptime në kuptim më të gjërë është një organizatë ku përdallim nga organizatat tjera tjera shteti ka karakter politik, që ushtron detyrimin shtetëror.

Pushteti është force organizimi. Organizon raportet midis individëve dhe merr në mbrojtje interes të tyre.

5.1. Format e qeverisjes

Sistemi politik paraqet një tërësi institucionesh formale ligjore që ndërtojnë një qeveri ose shtet. Sistemi politik ka detyrë kryesore regullimin e konflikteve që përndryshe do të shkaktonin shkatërimin e shoqërisë. Me nocion system nënkuptojmë një bashkim elementesh të ndryshme që lidhen në mes vete dhe formojnë një tërësi, e cila paraqet një unitet pjesësh elementesh të lidhura ngushtë dhe në marrëdhënje të caktuar mes tyre.³¹

Format politike të qeverisjes vijnë duke u shtuar dhe ndryshojnë në bashkëveprim me raportet e pushteti, kulturën dhe ekonominë në shoqëri. Ndryshimi i kulturave jep ndryshime politike.³² Sistemi politik është rrjet marrëdhënesh përmes të cilit qeveria prodhon vendime(politika), në

³⁰ Jonuz Abdullai, Politikat dhe politikat publike botimi iii, fq.67, 2016 Tetovë

³¹ Jonuz Abdullai, Politikat dhe politikat publike, 2016 Tetovë fq 93

³² Kvarl- Melbye- Tranoy, ,Politika dhe Demokracia, 2006

përgjigje të kontributeve (kërkesave apo mbështetjes), nga publiku I gjërë.³³ Për shumë studius të çështjes së sistemit politik, pikënisje ose udhërrëfyes ka qenë studimi shkencor i Dejvid Istonit, i cili analizon funksionimin e sistemit politik, si një input-output-eve dhe feedback-ut (hyrje-daljesh dhe kthyes).

Si I definojmë intpute?

Inputet në sistemin politik janë kërkesat dhe mbështetja.

Kërkesat shprehen në trajta dhe mënyra të ndryshme, si përmes anketave të opinionit public, partive politike, grupeve të interest, peticioneve drejtuar zyrtarëve të lartë dhe demonstrimeve paqësore.

Çjanë outputet

Outputet qeveritare janë ato që tregojnë se ç'farë bën qeveria. Ato përfshin hartimin e vendimeve, të ligjeve, vendosjen e taksave. Outputet janë përgjigje të inputeve, pra kërkesave dhe mbështetjes.³⁴

Daljet na tregojnë se cilat kërkesa të qytetarëve janë pranuar e cilat janë refuzuar.³⁵

Feedback-u?

Është opinion i qytetarëve ndaj daljeve siç janë vendimet, masat, propozimligjet, strategjitë dhe aktivitetet tjera të qeverisë. Këto reagime ose informata kthyesë të qytetarëve, mund të jenë të kundërshtuara ose të mbështetura nga shumica e qytetarëve, që do të thotë se vazhdon aktiviteti I organeve të pushtetit qendror në rishikimin- riformulimin, ndryshimin e vendimeve ekzistuese dhe hartimin e politikave të reja.³⁶

³³ Hayëood, 2008 fq 24

³⁴ Lambro Filo, Sistemet politike bashkëkohore, fq 42, Tiranë

³⁵ Jonuz Abdullai, Politikat dhe politikat publike, fq.90, 2010 Tetovë

³⁶ Jonuz Abdullai, Politikat dhe politikat publike, fq.90, 2010 Tetovë

III.PARTICIPIMI I QYTETARËVE NË POLITIKËBËRJE

3.1 Shqyrtimi i ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në janar të vitit 2006 e miratoi **Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik**, filloi të zbatohet më 1 shtator të vitit 2006.

Me këtë ligj kanë të drejtë të gjithë personat fizik dhe juridik të kërkojnë informata që iu nevojiten deri te institucioni përkatës.

Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik njëherë në vit (në mjetet për informim publik, buletin, web faqe) shpall listën e poseduesve të informacioneve me karakter publik dhe të personit përgjegjës të poseduesit të informacioneve³⁷

Qëllimi i këtij ligji është punë transparente e poseduesve të informacionit me karakter publik nga ana poseduesve të informacioneve.

Nga ky ligj shihet se të gjithë personat fizik dhe juridik kanë të drejtë për qasje të informative me karakter publik.

³⁷ Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik, 2006

Komisioni për mbrojtje të lirë të informative me karakterë publike njëherë në vit nëpërmjet mjeteve të informimit shpall listën e poseduesëve të dhe personave përfshijës të informative me karakter publik. Posueduesit e informacionit mund të refuzojnë kërkesën e dhenjës së informacionit në raste kur: nëse informacioni është klasifikuar me shkallë të lartë të fshehtësisë, , informacioni i cili rrezikon të drejtat e pronës individuale apo intelektuale si psh (patentat, model, shenjë e vendit të prodhimit) .

Pra çdo institucion cakton perdona zyrtar për realizimin e informative me karakter publik

Procesi i realizimit të informacionit sipas këtij ligji:

Kërkesë me gojë apo me shkrim

Kërkuesi qasjen e lirë në informacione mund ta kërkojë në mënyrë me gojë, të shkruar apo me shkrim elektronik;

Çdo kërkues në bazë të kërkesës ka të drejtë për qasje në informacionin e poseduesit të informacioneve me të cilat disponon, dhe atë me shqyrtim, përshkrim, fotokopjim apo shkrim elektronik. 2. Kërkim me gojë Neni 13 (1) Nëse kërkuesi kërkon qasje në informacion me kërkesë me gojë, poseduesi i informacionit është i obliguar që kërkuesit t'i mundësojë qasje në informacionin, në mënyrë me të cilën kërkuesi do të ketë kohë të mjaftueshme që të njoftohet me përmbajtjen, për çka poseduesi i informacionit thurr shënim zyrtarë, vetëm nëse ka të bëjë me informacionet e nenit 6 paragrafi 1 të këtij Ligji. (2) Nëse poseduesi i informacionit përgjigjet pozitivisht në kërkesën nga alinea 1 të këtij neni, menjëherë, e më vonë në afat prej dhjetë ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës mundëson njohjen për përmbajtjen e informacionit të kërkuar në mënyrë që i jep në shqyrtim apo t'i siguron shkrim, fotokopjim apo shkrim elektronik nga informacioni i kërkuar. (3) Nëse poseduesi i informacionit përgjigjet negativisht në kërkesën, apo nuk mundet menjëherë të përgjigjet në kërkesën, si dhe nëse kërkuesi ka kundërshtim apo të shkruar për mënyrën e njoftimit me informacionin, personi zyrtarë për ndërmjetësim me informacione është i obliguar që për kërkesën të përgatisë shënim zyrtarë në të cilën do të shkruaj të dhënat për kërkuesin, datën e pranimit të kërkesës dhe ta njoftojë kërkuesin për kërkesën e veçantë, gjegjësisht për informacionin e kërkuar. (4) Në rastet nga paragrafi 3 të këtij neni procesi i mëtejme me kërkim verbal vazhdon sikur me kërkesën e shkruar në pajtueshmëri të këtij Ligji. 3. Kërkesë me shkrim Neni 14 (1) Për kërkesën e shkruar për qasje në informacione vendos poseduesi i informacioneve në procesin e vërtetuar në këtë Ligj (2) Për

çështje të procesit nga paragrafi 1 të këtij neni të cilat nuk janë të rregulluara me këtë Ligj, zbatohen dispozitat nga Ligji për procesin e përgjithshëm juridik.

Dorëzimi i përgjigjes pas informacionit të kërkuar

Nëse poseduesi i informacionit në kërkesën përgjigjet pozitivisht, menjëherë kërkuarit i mundëson njohjen me përmbajtjen e informacionit të kërkuar dhe atë me shqyrtim, fotokopje apo me shkrim elektronik

Gjuha në të cilën dorëzohet kërkesa

Kërkuari kërkesën e dorëzon te poseduesi i informacionit në gjuhën maqedonishte dhe në fletën e tij cirilike, kurse kërkuari i cili e flet gjuhën zyrtare ndryshe prej gjuhës dhe letrës maqedonase, kërkesën mund ta dorëzojë edhe në gjuhën zyrtare të cilën e përdor në pajtueshmëri me ligj.

Refuzimi dhe lajmërimi për kërkesën

Poseduesi i informacionit në tërësi apo pjesërisht mund ta refuzojë kërkesën, nëse vërteton se informacioni i kërkuar është kërkesë e nenit 6 paragrafit (1), kurse gjatë asaj duke pasur parasysh edhe nenin 6 paragrafi (3) të këtij ligji. (2) Nëse kërkesa ka të bëjë me informacion me të cilin nuk disponon poseduesi apo nëse informacioni i kërkuar tanimë është shpallur në pajtueshmëri me nenet 18 dhe 23 të këtij ligji, kërkuari lajmërohet në formë të shkruar.

Të drejtë në mbrojtje juridike

Të drejtë në mbrojtje juridike në pajtueshmëri me këtë ligj kërkuari i cili ka dorëzuar kërkesë me shkrim për qasje në informacione.

Procesi për ankesë

Kundër vendimit me të cilin poseduesi i informacionit e ka refuzuar kërkesën, kërkuari ka të drejtë në ankesë me afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik.

Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik vendos për ankesën e kërkuarit në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ankesës. (4) Procesi për ankesën nga paragrafi 2 të këtij neni zbatohet sipas dispozitave të Ligjit për procesin e përgjithshëm drejtues. Shqyrtimi në kërkesën e kërkuar është pa pagesë.

Dispozita ndëshkuese

Me gjobë do të dënohet prej 30.000 deri më 50.000 denarë për kundërvajtje, gjegjësisht personi zyrtar te poseduesi i informacionit i cili nuk do të japë informacion me karakter publik në pajtueshmëri me dispozitat e këtij Ligji.³⁸

Nga shqyrtimi i këtij ligji e kmei të qartë se si duhet të arrijmë te një informatë me karakter publik.

Sic cekëm më lartë ligj parasheh formularë që ju mund t'i dërgoni institucionit përkatës që doni të merrni përgjigje. Intitucioni i të cilit kemi bërë kërkesë në afat prej 30 ditëve duhet të na kthejë përgjigje. Gjithashtu në këtë ligj mund të bëjmë parashtrësë me gojë në institucionin që kërkojmë informatë me karakterë publikë dhe në afat 5 ditë duhet të kemi një përgjigje.

Më tej ky ligj shpjegon të dejtat dhe obligemt, mënyrën e punes, mbrojtjen gjygsore e komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik.

Sipas përvojës së gazetarëve, ministritë e financave dhe punëve të brendshme janë institucionet më të mbyllura në vend. MPB, gati se në të gjitha rastet thirret në informata të kualifikuara, kurse ministria e financave nuk përgjigjet ose bënë gjithçka që ta refuzojë kërkesën. Ministria e financave fsheh se sa para u ka paguar njerëzve të arrestuar pabazë apo ndjekur penalisht në Maqedoni, për fshehtësi e llogarit edhe numrin e njerëzve të cilët kanë mbushur kushtin për pensionim, por që kanë kërkuar vazhdim të stazhit të punësimit dhe një sërë çështje tjera për të cilat paratë paguhen nga buxheti dhe këto informata në asnjë rast nuk mund të jenë sekrete.³⁹

3.2 Format e pjesëmarjes së drejtëpërdrejtë të qytetarëve

Format e pjesëmarjes të drejtëpërdrejtë në vendosjen e çështjeve me karakter lokal janë:

1. Iniciativa qytetare; 2. Tubimet e qytetarëve; 3. Referendumi.

Iniciativa qytetare qytetarët kanë të drejtë t'i propozojnëv Këshillit të njësive të qeverisjes të sjelëe akte të caktuara ose ta zgjedhë ndonjë çështje të kompetenca të veta, nëqoftëse e përkrahin së paku 10% e zgjedhësve. Diskutimin Këshilli është i detyruar ta mbajë mbrenda 90 ditëve pas paraqitjes së propozimit dhe t'i informojë qytetarët për vendimet e marra.

Tubimi i qytetarëve mund të bëj cdo qytetarë ka të drejtë të merrë pjesë në vendimarrje përmes iniciativave të dryshme si propozim planet, programet buxhetin etj.

³⁸ Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik, 2006

³⁹ <http://verifikimiifakeve.mk/si-manipulohet-ligji-per-qasje-te-lire-deri-te-informatat-me-karakter-publik/>

Referendumi është form më e qëlluar e pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë të qytetrëve në vendosjen për çështje me rëndësi lokale. Referendumi është forma më e lirë e shprehjes së vullnetit të qytetarëve, pra është forma më demokratike. K ëshilli i njësisë së qev erisjes lokale mund të shpall referendum me iniciativën e vet, apo nëse ka 20% të votuesve të njësisë. Të drejtë votimi kanë qytetarët, që kanë të drejtën e zgjedhjes. Votimi është i fshehtë. Vendimi i Referendumit pranohet nëse kanë votuar shumica e zgjedhësve që kanë votuar ose votim marrin pjesë më shumë se gjysma e numrit të zgjedhësve.⁴⁰

Institucionetshtetore në Maqedoni e kanë për detyrë t'i informojnë qyteterëv, informimi I një institucioni shtetërtorë bëhët nëpërmjet:

Personit për marrëdhënje me publikun, Raportit vjetor, Seancave të hapura të këshillit, ditëve të hapura për pranim, komunikim me mediat ëeb portalet etj.

Nëpërmjet debateve publike qytetrët kërkojnë llogaridhënje nga vendimet që do të merren me programet, buxhetin etj. Në këto debate qytetarët direkt do të shprehin problemet, nevojat dhe t'i hprehin idetë dhe mendimet për nevojat e tyre.

Tribuna publike, anketa nëpër komuna

Gjatë përgatitjes së rregullave të komunës, këshilli përkatësisht kryetari i komunës, paraprakisht mund të organizojë tribuna publike, të realizojë anketa ose të kërkojë propozime nga qytetarët. Tribuna publike ligjërisht nuk është mjaftueshëm e përcaktuar, por ajo mund të jetë formë e rëndësishme institucionale për përfshirjen e qytetarëve në jetën shoqërore. Tribuna publike jep mundësi, që secili individ të përfshihet në debat për çështje të caktuara dhe në mënyrë kritike ta shqyrtojë, që të gjenden zgjidhje adekuate. Derisa tubimi i qytetarëve organizohet për qytetarët, të cilët drejtëpërdrejtë janë të prekur si banorë të një territori të caktuar, në tribunën publike mund dhe duhet të angazhohet opinionimi më i gjerë. Për tribunat publike mund të vlejnë rregullat e njëjta të dhëna në këtë udhëzues që tregojnë si të bëhet tubim i suksesshëm i qytetarëve. Anketat mundësojnë që administrata komunale dhe kryetari i komunës të provojnë mendimin e qytetarëve në lidhje me një politikë ose projekt të caktuar.

Opinionimi mund të përfshihet gjatë hartimit të dispozitave dhe akteve tjera, përmes debatit publik i cili për kompetenca të caktuara të komunës është i rregulluar me dekrete nga Qeveria e

⁴⁰ Esat Stavileci, Agni Aliu Struktura dhe metodat e qeverisjes lokale 2003 fq 89-90

Republikës së Maqedonisë. Sipas këtyre dekreteve, komuna duhet t'i mundësojë opinionit në mënyrë efektive të merr pjesë në hartimin e dispozitave dhe në sjelljen, ndryshimin dhe plotësimin e dokumenteve të planifikuara, si për shembull ato nga sfera e urbanizmit, mjedisit jetësor etj.⁴¹

Qytetarët kanë të drejtë t'i propozojnë këshillit që të sjell akt të caktuar ose të zgjedh një çështje të caktuar nga kompetencat e veta. Këshilli komunal është i obliguar që të debatojë në lidhje me propozimin nëse atë e mbështesin më së paku 10 % e zgjedhësve të komunës ndërsa debate për çështjen e propozuar këshilli është i obliguar ta mbajë më së voni në afat prej 90 ditësh pas iniciativës së dorëzuar dhe t'i informojë qytetarët për vendimin e vet. Gjatë hartimit të dispozitave të komunës, këshilli, respektivisht prefekti mundet paraprakisht të organizojë tribuna publike, të realizojë anketa ose të kërkojë propozime nga qytetarët⁴²

3.3 Roli i qytetarëve të Maqedonisë në procesin e vendimarrjes

Sistemi juridik i Republikës së Maqedonisë nuk e garanton drejtëpërdrejtë të drejtën e qytetarëve për përfshirje në procesin e hartimit të buxheteve dhe shfrytëzimit të tyre. Si që kemi parë paraprakisht, supozohet që mbikëqyrja, gjegjësisht kontrollimi financiar të kryhen nga organet shtetërore. Prapëseprapë, ligjet nuk e përjashtojnë mbikëqyrjen qytetare të shfrytëzimit të buxhetit. Në nivel nacional, ekziston e drejta kushtetuese për propozimin e ligjeve dhe ndryshimin e akteve ekzistuese ligjore, e drejta për të ndikuar përmes deputetëve në dokumentet e miratuara nga Kuvendi, e drejta e marrjes së informatave sipas Ligjit për qasje ndaj informatave, dhe ekzistojnë zyrat për kontakt me qytetarët, pyetjet e deputetëve dhe mekanizma të ngjajshëm. Madje mund të thuhet se në nivel lokal qytetarët inkurajohen të ndërmarrin aktivitete të këtilla, në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Kushtetuta dhe Ligji për vetëqeverisje lokale konfirmojnë se njësitë e vetëqeverisjes lokale e gëzojnë të drejtën e vetëqeverisjes lokale, përmes pjesëmarrjes të drejtëpërdrejtë të qytetarëve, gjatë vendim-marrjes së lidhur me interesat e përgjithshëm ose të qytetarëve. Përveç kësaj, mbledhjet në të cilat diskutohet për buxhetin komunal, llogarinë vjetore të buxhetit dhe planet urbanistike, nuk mund

⁴¹ Udhëzues për qytetarë, Asociacioni MOST, Shkup 2011.

⁴² www.tetovo.gov.mk/getart.aspx?aid=39&lan=1

të jenë të mbyllura për opinionin publik. Është e rëndësishme të theksohet se pas skadimit të vitit fiskal, Këshilli komunal e miraton llogarinë vjetore të buxhetit të komunës. Llogaria vjetore i përmban të gjitha të hyrat dhe të dalat e planifikuara dhe të relizuara, për të gjithë shfrytëzuesit e buxhetit komunal. Pas miratimit të llogarisë vjetore, Kryetari i komunës e informon opinionin publik për përmbajtjen e saj. Ndonëse korniza ligjore e Republikës së Maqedonisë nuk e garanton drejtëpërdrejtë mundësinë e mbikëqyrjes qytetare të buxhetit, ajo e mundëson këtë. Është çështje tjetër se a është mbikëqyrja në agjendën e asociacioneve qytetare dhe/ ose organizatave joqeveritare. Roli i sektorit qytetar dhe organizatave joqeveritare është zhvillimi i sistemit efikas dhe transparent të mbikëqyrjes, i cili do ta promovojë realizimin e kujdesshëm të buxheteve të miratuara, me çka do të zvogëlohet korrupsioni dhe menaxhimi i keq me resurset publike. Ka lloje të ndryshme të aktiviteteteve, për shembull, organizatat joqeveritare mund të përqëndrohen në mbikëqyrjen e shpenzimit të mjeteve të buxhetit për dedikimet ose programet specifike të parapara, si për shembull ndërtimin e ndonjë shkolle ose rruge. Ata mund ta mbikëqyrin edhe realizimin e drejtë të politikave publike, dhe se a janë shpenzuar mjetet buxhetore për qëllimet e parapara, gjegjësisht a janë shpenzuar ato në mënyrë ekonomike. Roli i sektorit qytetar do të jetë edhe më i madh pas miratimit të Ligjit për qasje ndaj informatave. Me këtë Ligj realizohet parimi kushtetues i cili e garanton qasjen e lirë ndaj të dhënave, lirinë e pranimi dhe bartjes së informatave, si dhe publicitetin e punës së poseduesve të informatave. Nga ana tjetër, poseduesit e informatave janë të obliguar që opinionit publik t'i sigurojnë qasje ndaj teksteve të akteve, programeve, strategjive dhe dokumenteve tjera të lidhura me fushëveprimin e tyre, si dhe mënyrën në të cilën e bëjnë këtë. Sipas Ligjit, do të formohet Komisioni për mbrojtjen e të drejtës të qasjes së lirë ndaj informatave me karakter publik, i cili do të jetë i pavarur në punën e tij, dhe miratimin e vendimeve në suazat e ingerencave të parapara me këtë Ligj. Mjetet për punën e Komisionit do të sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Komisioni e ka selinë në Shkup, dhe për punën e saj i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, të cilës i parashtron raport vjetor për punën e saj. Komisioni do të përbëhet prej pesë anëtarëve, prej të cilëve njëri është kryetar, dhe tjetri zëvendës i kryetarit. Anëtarët do të kenë mandat pesëvjeçar, me mundësi të rizgjedhjes, dhe do ta kryejnë punën e tyre në mënyrë profesionale. Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit bëhet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, sipas propozimit të Qeverisë. Për realizimin e plotë të Ligjit në interes të qytetarëve, është esenciale që Komisioni të jetë me të vërtetë i pavarur, të ekzistojë vullnet

politik për aplikimin e ligjit dhe administrata të jetë e trajnuar për dhënien e informatave të kërkuara nga qytetarët. Në Maqedoni nuk ka mundësi ligjore për buxhetim pjesëmarrës, por duhet të mendohet për shfrytëzimin e diskutimeve publike para miratimit të vendimeve të rëndësishme, si për shembull miratimin e buxhetit vjetor në nivel komunal ose gjatë shqyrtimit të nevojës për ndryshimin e taksave për shërbimet lokale. Në fakt, mundësia për tubimet publike është paraparë me draftin e Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale. Fatkeqësisht, drafti i ligjit është shqyrtuar në mbledhjen e Qeverisë më 10 dhjetor 2003, ku është vendosur të mos përfshihet dispozita me të cilën pushtetet lokale obligohen të mbajnë tubime publike për buxhetet.⁴³ E drejta e qeverisjes locale nënkupton të drejtën e qytetarëve të vendosin për punët me karakter lokal.⁴⁴

Analizë e projektit “Shkupi 2014”

Projekti shkupi 2014 është projekti më i madh ndër vite në Maqedoninë

Projekti u parapra me programën e punës së qeverisë 2008-2012, nga koalicioni qeveritar VMRO-DPMNE dhe BDI.

Ky projekt ka nxitur debate të shumta etnikke dhe ndërpartiake, opozitë-pozitë.

Qytetarët e komunës Qendër kanë kërkuar nga kryetari Zhernovski që ky projekt të ndërpritë pasi ato e quajnë në çmenduri “SHkupi 2014”

kostoja fillestare për këtë projekt, u paralajmërua se do të jetë 80 milion euro, por ka kaluar mbi 633 milionë euro.

Por qytetarët nuk kanë qenë aspak të informuar sesa para janë harxhuar dhe si janë harxhuar paratë jo transparenca e këtij projekti solo zbatim të politikave jo efektive në Republikën e Maqedonisë.

Kryetari i komunës qendër Zhernovski formoi komisionin për revision të projektit Shkupi 2014.

⁴³ Udhëzues për buxhetet, d-r Zhidas Daskalovski m-r ana nikolovska m-r marija risteska 2006 shkup

⁴⁴ Karta evropiane e vetëqeverisjes locale, 1985, Strasburg

Komisioni vlerësoi se pushteti qendror apo qeveria ka financuar pjesën më të madhe të përmendoreve dhe se ajo i kishte transferuar paratë në llogarinë e komunës Qendër. Sipas komisionit, ky transferim për qëllime të tilla është i paligjshëm, për shkak se nuk ka ligj për përkrahjen e projekteve të tilla dhe transferimin e parave për qëllime të kësaj natyre.⁴⁵

Akademiku Abdylmenaf Bexheti thotë se i gjithë projekti „Shkupi 2014“ kushton më shumë se 633 milionë euro, në rast se do të përllogaritet çmimi i kapitalit dhe fitimi i humbur sepse paratë janë shpenzuar në mënyrë joproduktive dhe jo për ndërtimin e rrugëve dhe hidrocentraleve ose nuk janë investuar për transportin hekurudhor. „Është humbur një fitim i mundshëm nga investimet në alternativa oportune, si për shembull për rrugë, hidrocentrale, rrjete gazi ose linja hekurudhore, ndërsa e gjithë kjo do ta kushtojë shtetin shumë më tepër. Gjithashtu, gjatë gjithë këtyre viteve shteti vazhdoi të marrë borxhe me kamata të shtrenjta, ndërsa paratë ndër të tjera i harxhoi për projektin „Shkupi 2014“, që do të thotë se çmimin që do ta paguajmë në fund do jetë akoma më i shtrenjtë“, thotë akademiku Bexheti.

Përllogaritjet tregojnë se në rast se do ishin kursyer paratë e shpenzuara për projektin „Shkupi 2014“, pushteti pa asnjë problem mund të kalonte dy vite pa marrë borxhe. Në këtë mënyrë borxhi publik sot do ishte 3,3 miliardë euro ose rreth 39% të prodhimit vendas bruto. Një nga argumentet kryesore në rastet kur përfaqësuesit e Qeverisë sqaronin nevojën e projektit „Shkupi 2014“ ishte zhvillimi i turizmit. „Për mendimin tim është mirë të ndërtohet. Në këtë mënyrë jo vetëm që angazhohet në punë operativa e fushës së ndërtimit, por ndërtohen edhe të mira publike. Projekti ‘Shkupi 2014’ ka më shumë dimensione. Ai ka dimensionin e zhvillimit të turizmit, për tërheqjen e më shumë turistëve, më saktësisht me këtë projekt ka çfarë të shihet dhe çfarë të tregohet. Turistët duan të shohin diçka interesante, atraktive dhe të veçantë“, tha kryeministri Nikolla Gruevski në vitin 2010, kur u ngritën përmendoret e para të projektit në fjalë. Të dhënat e Entit shtetëror të statistikës tregojnë se numri i vizitorëve që qëndrojnë në Shkup pesë viteve të fundit shënon rritje.⁴⁶

⁴⁵ <http://www.telegrafi.com/lajme/qeveria-58-milione-euro-te-paligjshme-per-shkupi-2014-79-4584.html>

⁴⁶ <https://lajmi.net/sikur-te-mos-linde-shkupi-2014-do-te-rilinde-ekonomia-e-maqedonise/>

Nga këndvështrimi im për këtë projek tani, dhe nga informatat e përgjithshme cka kam mund të them se ky project është i dështuar. Arkitektët janë të mendimit sa I përket formës dhe përmbajtjes ky project është i dështuar, sot fasadat e këtija projekti kanë filluar të prishen.

Gjithashtu ka krijuar përçarje ndëretnike, ka tensionuar marrëdhëniet me shtetet fqinje Bullgarinë dhe Greqinë.

Pra, mund të konkludojmë se në hartimin e këtij projekti qyterat nuk janë pyetur se a pranojnë një projekti kaq gjigant të realizohet. Pasi që ky project ka marrë miratim nga Parlamenti, që në fazat fillestare e deri në mbarimin e këtij projekti nuk është dhënë llogari të qartë financiare, e as me një plan se çfarë parashihet të ndërtohet, apo se kur mund të përfundojë ky projekt që shpeshherë ka qenë objekt i tensioneve.

IV. SHPALOSJA E REZULTAVE

4.1 Hipotezat e parashtruara

Hipoteza kryesore:

- 1.Puna e aktorëve në procesin e politikëbërjes në R.M është transparente.

Hipoteza ndihmëse:

- 2.Qytetarët janë të kënaqur me rolin e tyre aktiv në procesin e vendimmarjes në R.M.

Prezentimi i rezultateve nga hulumtim

Anketës sime i janë përgjigjur 120 të anketuar. Pjesën e anketës e kamë realizur me qytetarë të komunës së Tetovë dhe rrethinë. Kjo anketë i ka 17 pyetje. Përpunimin e rezultateve e kamë realizuar në Microsoft Excel dhe në Microsoft Word. Pra në vazhdim do t'i shpalosim rezultatet nga anketa e realizuar.

Metodat që janë përdorur në këtë punim:


Metoda e analizës së përmbajtjes si dhe metodat statistikore.

Gjithashtu do te përdoren edhe teknika si:

1. Anketa - pyetsor që do të realizohet me qytetarët në nivel lokal.

1. Gjinia


a) Femer b) Mashkull



Nga pytja e parë sipas gjinisë shihet se kësaj ankete i janë përgjurr 63 % të gjinisë femërore ndërsa nga gjinia mashkullore i janë përgigjur 37%

2. Mosha


a) 18-25 b) 26-35 c) 36-45 d) 45+



Pra sic shihet mosha e të anketuarëve 41% jnaë të moshës 26 deri 35 vjet; me 33% moshës 18 deri 25, mosha 36-45 33 % dhe mbi moshën 45 vjecare me 6 %.

3. Vendbanimi:


a) Qytet b) Fshat



Vendbanimi i të anketuarëve nga qyteti janë 61% dhe nga fshati 39% e të anketuarëve.

4. A jeni të informuar lidhur me politikat publike në rafshin lokal?

a) Po b) Jo c) Pak d) Deridiku e) Aspak




47% e të anketuarëve kanë thënë se janë të informuar me politikat publike në rafshin lokal, 19% nuk janë të informuar, deri diku me 3 % dhe aspak 4%

Sa I përket anketës në këtë pyetje pra pjesa më e madhe e qytearëve janë përgjigjur se pak janë të informuar me politikat publike, kumë pas një pjesë e madhe aspak nuk dinë se çfarë vendime merr komuna në lidhje me politikat publike në nivel lokal, dhe shihet se një grup i madh të të anketuar janë përgjigjur me jo të informuar.

5. A keni marrë pjesë në debatet e organizuara nga pushteti lokal lidhur me buxhetin e komunes?


a) Po b) Jo



Nga kjo përgjigje e marrë me 3% Po dhe 97% Jo është për t'u habitur , ku mund të themi se qytetarët nuk marrin pjesë në debata në lidhje me buxhetin në nivel lokal.

6. Sa jeni te kenaqur me zbatimin e politikës se mirembajtjes se higjines ne vendbanimin tuaj?


a) Aspak b) Pak c) Deridiku d) Shumw



Mirembajtjes se higjines ne vendbanimin ku jetojnë të anketuarit e kësaj ankete me 79% ku aspak nuk janë kënaqur nga mirëmbatja e higjienës, 7% pak, deri diku 6% dhe me 8% shumë.

7. Mbrojtja e ambientit është obligim i:


- a) Komunes b) Pushteti qendror (Ministrise se Ambientit) c) Qytetareve
d) Te gjithëve



64 % të kësaj pyetje janë të mendimit se mbrotja e ambientit i takon të gjithëve; 21% qytetarëve; 7% komunës dhe 7 % Pushtetit qendror.


8. Cili është roli i kryetarit të komunes në hartimin dhe zbatimin e një politike publike?

a) Formal b) Fiktiv c) Ekzekutiv d) Ska rol vendimarrës



59% janë të mendimit se Kryetari i komunes ka për një politikë publike ka rol formal
19% Fiktiv, 13% Ekzekutiv dhe 9 % ska rol vendimarrës.


9. Sipas jush, a ben qeveria diskriminim ne shperndarjen e mjeteve (granteve dhe bllok dotacioneve) ne baze te perkatesise nacionale ne komunat me shumice te populates shqiptare dhe atyre maqedone?
- a) Po b) Jo c) Nuk e di



87% janë të mendimit se qeveria bën diskriminim ne shperndarjen e mjeteve, 6% janë të mendimit se Qevira nuk bën diskrimin dhe 7% nuk e dinë.

10. Sipas jush, nese qeveria ben diskriminim ateherë ai behet tek :

- a) Popullata me shumice shqiptare
- b) Popullata me shumice maqedone
- c) Popullate te perzier




98% janë të mendimit se qeveria ben diskriminim te Popullata me shumice shqiptare, 2 % janë të mendimit se ka diskriminim gje popollata e përzier dhe 0% te pupullata me shumicë maqedonase, të gjithë të anketuarit janë të mendimit senuk ka diskrimin te pupullata maqedonase.

11. A mendoni se komuna e Tetovës është transparente?

A) PO

B) JO




76% e pupullatës mendojnë se komuna e Tetovës nuk është transparente dhe 24% janë të mendimit se komuna është transparente.

12. A keni bërë kërkesë për ndonjë informatë me karakter publik në komunën e tetovës?

A) PO

B) JO



91% nuk kanë bërë kërkesë për një informatë me karakter publik dhe 9% kanë bërë kërkesë për një in format me karakter publik.


13. A Keni vizituar ëeb-faqen e komunës së Tetovës?

A)PO

B)JO

C)NDONJËHERË

D)ASPAK




50% kanë vizituar ëeb faqen e kom unës së Tetovës, 28% jo 14% Ndonjëher dhe Aspak me 8 %.

14. A keni marrë pjesë në ndonjë seancë të Këshillit?

A)PO


B)JO



98% nuk kanë marrë pjesë në seancë të Këshillit dhe vetëm 2% e të anketuarëve kanë marrë pjesë në seancë të Këshillit.

15.Sipas jush çka mendoni se duhet të ketë prioritet komuna e Tetoves ne periudhen e ardhshme ne sferen e politikës publike?


- A) Rregullimin e planit hapësinor
- B) Sigurimit të ujit për pije
- C) Ceshtjen e mbeturinave dhe ambientit jetësor
- D) Tjetër _____



52% Sigurimit te ujit për pije prioritet i komunës së Tetoves ne periudhen e ardhshme 26% Rregullimin e planit hapesor , 17% Ceshtjen e mbeturinave dhe ambientit jetesor, d) tjetër


16. Si i vleresoni politikat e komunes mbi ceshtjet qe u tangojne rinine?

a) Arsimi (vleresimi 1-2-3-4-5, ku 1 eshte nota me e dobet ndersa nota 5 me e mire)




Cështjen që e tangojnë arsimin sipas kësaj tabela ka notë 3

b) Punesimi (vleresimi 1-2-3-4-5)




Punësimi ka gjithashtu notën 3.

c) Sigurimi i hapësirave të gjelbërta dhe sportive (1-2-3-4-5)




Sigurimi i hapsirave të gjelbërta ka notën 3.

d) Jeta kulturore (1-2-3-4-5)




Jeta kulturore ka notën 3 poashtu.

e) Menaxhimi me qente endacak (1-2-3-4-5)



Menaxhimi me qentë endacak ka notën 3.

f) Infrastruktura rrugore (1-2-3-4-5)



Infrastruktura ka notën 3

17. Komenti juaj per politikat e komunes se Tetoves:

Kësai pyetje i është përgjigjur vetëm një i anketua edhe atë:

“Qytetrët bashkërisht me konuën e Tetovës duhey që të gjejnjë në udhelidhësë që sadopak ne si qytetarë të kemi më shumë informata për politikat vendimarrësë që na tangojnë në qytetin tonë.”

4.2 Përmbledhje

Nga anketa e relizuar kamë arritur që të ngre zërin e qytetarit në vendimarrjen e politikave, dhe tani qytetarët janë të informuar për çështjet që I tangojnë.

Nga gythe punimi im mund të shohim hipotezat e ngritura

Hipoteza kryesore:

Puna e aktorëve në procesin e politkëbërjes në komunën e R.M është transparente, kjo hipotezë bie posht pasi pushteti qëndror dhe pushtti lokal nuk informon qytetarët me vendimet e marra dhe nuk organozon tributa dhe debate.

Hipoteza ndihmëse:

Qytetarët janë të kënaqur me rolin e tyre aktiv në procesin e vendimarrjes në komunën e Tetoves gjithashtu edhe kjo hipotezë bie posht pasi qytetarën nuk marrin pjesë në mirratimin e buxhetit të komës së Tetovës.

KONKLuzionet

Në fuund të punimit unë kamë dalur me disa konzluzione si:

- Sipas projektit Shkupi 2014 qytarët aspak nuk kanë qenë të kënaqur nga puna përfubdimtare e këtij projektit dhe pos hargjime marramendësë ka shkaktuar edhe përcarje ndëretnike.
- Qeveria nuk I inkuadron qytetarët lidhur me projektet që duhet të miratohen por as që jep detajr lidhur me mjete financiare të hargjuara.
- Komuna e Tetovëkë ndërmerë masa të mjaftueshme lidhur me cështje infrastrukturore, menaxhimin e mbeturinave, qenëve endacak, ngritjen e hapsirave publike, ndotjen e ajrit.
- Komuna e Tetovës nuk ka zgjedhur problemin me ujin për pije për qyterarët e komunës së Tetovës.
- Komuna e Tetovës është deri diku transparente në marrjen e informative me karakter publik.
- Informimi mediadik lidhur me punësn e institucioneve publike është në një nivel mesatar apo të themi të dobët dhe qyterët nuk janë shumë të informuar për punën e këtyre institucioneve.
- Qytetarët nuk jane aktiv me marrjen e vendimive në komunën e Tetovës si punën e këshillit dhe miratimin e buxhetit.
- Ligji për informata me karakter publik përmban cdo informat që I duhet qytetarit në marrjen e një informate me karakter publik.

REKOMANDIME

Nga gjithë punimi dhe informi më I hollësishëm nga punimi im kamë dalur me këto rekomandime si në vijim:

- Funkcioni dhe kordinimi professional I brendshëm I komunës së Tetovës me qëllim të aftësimt të organeve shtetërore për më shumë politika globale;
- Deconalizimi i pushtetit lokal nga ai shtetëror;
- Qevira e RMV të jetë transparente ndaj projektve të mëdha, të organzoj tribuna debate publikeër projektet dhe programet e parapara;
- Informimi i saktë dhe I qartë në media për punën e institucioneve shtetërore dhe lokale.
- Zbatimi i plotë I ligjit për informata me karakter publik sin ë ato shtetërore dhe në ato lokale
- Gjithashtu qytetarët të bëjnë më shumë shpypje instiituioneve shtetërore dhe lokale nëpërmjet fprmave të paraparam e ligj pët krijimin e politikave që i tangojne ato.
- Vetëdisimi I qytetarëve për nismat për Referendum

SHTOJCA

5.1 Anketa

Pyetesor (Per teze te masterit “Participimi i qytetareve ne procesin e politikberjes ne sferen publike ne R.M.)

Kandidate ne studimet master Lumturije Luma

Mentor i tezes se masterit: Prof.dr. Jonuz Abdullai

Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike – UEJL, Tetove

9. Gjinia

a) Femer b) Mashkull

10. Mosha

a) 18-25 b) 26-35 c) 36-45 d) 45+

11. Vendbanimi:

a) Qytet b) Fshat

12. A jeni te informuar lidhur me politikat publike ne rafshin lokal?

a) Po b) Jo c) Pak d) Deridiku e) Aspak

13. A keni marre pjese ne debatet e organizuara nga pushteti local lidhur me buxhetin e komunes?

a) Po b) Jo

14. Sa jeni te kenaqur me zbatimin e politikës se mirembajtjes se higjines ne vendbanimin tuaj?

a) Aspak b) Pak c) Deridiku d) Shume

15. Mbrojtja e ambientit eshte obligim i:

a) Komunes b) Pushteti qendror (Ministrise se Ambientit) c) Qytetareve
d) Te gjitheve

16. Cili eshte roli i kryetarit te komunes ne hartimin dhe zbatimin e nje politike publike?

a) Formal b) Fiktiv c) Ekzekutiv d) Ska rol vendimarrës

17.Sipas jush, a ben qeveria diskriminim ne shperndarjen e mjeteve (granteve dhe bllok dotacioneve) ne baze te perkatesise nacionale ne komunat me shumice te populates shqiptare dhe atyre maqedone?

a) Po b) Jo c) Nuk e di

18.Sipas jush, nese qeveria ben diskriminim ateherë ai behet tek :

- a) Popullata shumice shqiptare
- b) Popullata shumice maqedone
- c) Popullate te perzier

19.A mendoni se komuna e Tetovës është transparente?

B) PO B) JO

20.A keni bërë kërkesë për ndonjë informatë me karakter publik në komunën e tetovës?

B) PO B) JO
C)

21.A Keni vizituar ëeb-faqen e komunës së Tetovës?

A)PO B)JO C)NDONJËHERË D)ASPAK

14. A keni marrë pjesë në ndonjë seancë të Këshillit?

A)PO B)JO

15.Sipas jush çka mendoni se duhet të ketë prioritet komuna e Tetoves ne periudhen e ardhshme ne sferen e politikës publike?

- E) Rregullimin e planit hapësiror
- F) Sigurimit të ujit për pije
- G) Cështjen e mbeturinave dhe ambientit jetësor
- H) Tjetër _____

16. Si i vlerësoni politikat e komunës mbi cështjet që u tangojnë rrinë?

- a) Arsimi (vlerësimi 1-2-3-4-5, ku 1 është nota më e dobët ndërsa nota 5 më e mirë)
- b) Punësimi (vlerësimi 1-2-3-4-5)
- c) Sigurimi i hapësirave të gjelbërta dhe sportive (1-2-3-4-5)
- d) Jeta kulturore (1-2-3-4-5)
- e) Menaxhimi me qen të endacak (1-2-3-4-5)
- f) Infrastruktura rrugore (1-2-3-4-5)

17. Komenti juaj për politikat e komunës së Tetovës:

BIBLIOGRAFIA

- Adem Shala: Roli dhe ndikimi i grupeve të interesit dhe grupeve për presion në institucionet dhe proceset politike, Prishtinë, 2001
- Aristoteli, Politika, Tiranë, 2003

- Bajram Pollozhani, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë; Republikës së Shqipërisë; Republikës së Kosovës, Shkup, 2011
- Catherine F. Smith, In Writing Public Policy, Third Edition, Oxford, 2012
- David Turman, The Governmental Process, Neë York, 1951
- Elena Andreevska, Bazat e se Drejtës nderkombetare Publike , Tetovë, 2008
- Elmi Aziri, Ndikimi i investimeve publike në rritjen ekonomike, Kumanovë, 2009
- Eugene A. Bardach, Pratical Guide for Policy Analysys, Neë York, 2005
- Luan Omari, Sistemi parlamentar, Tiranë, 2003
- Florim Ajdini, Zeqir Kadriu, Etem Aziri: Bilinguozmi i integruar në administratën publike të nivelit lokal, Tetovë, 2008
- François d'Arcy, Politikat e Bashkimit Evropian, Tiranë, 2007
- Gabriel Almond., Political Science, Oxford, 1996
- Glen Tinder, Mendimi politk, Tiranë, 1996
- Ivan Grdesic, Osnovne analize javnih politika, Zgreb, 2006
- James E. Anderson, Public policy: An Introduction, Houghton Mifflin Co. 1994
- James E. Anderson, Public policymaking: an Introdoction, Boston, 1994
- Jonuz Abdullai, Politika dhe politikat publike, Tetovë, 2010
- Martin Potuček, Lanske. T Lepup, Gorgu Jenei, Laslo Varadi, Javna politika vo sredna i vo istočna Evropa, Skopje, 2003
- Michael E. Kraft, Scott R. Furlong, Public Policy: Politics, Analysis, and Alternatives, 4th Edition, California, 2012
- Mishel Verpo, E drejta publike, Shkup, 2012
- Rexhep Meidani, Mbi qeverisjen, Tiranë, 2009
- Thomas R. Dye, Understanding Public Policy, 12 edition, Prentice Hall, 2007
- Vasilika Kume, Planifikimi Strategjik në Organizatat publike jofitimprurëse, Tiranë, 2005
- Verner Vajdenfeld, Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Evropën Lindore, Tiranë, 1999
- Veton Latifi, Teoritë e shkencave politike, Shkup, 2007
- Viljam. N. Dan, Analiza na javnite politiki, Skopje, 2009
- Ë. Phillips Shively, Hyrje në shkencat politike, Tiranë, 2010

- Public administration N. Joseph Cayer David I. Backer Lois F. Eeschler third edition San Diego 2010
- Performance Management in the Public Sector Geert Bouckaert, John Halligan, and Wouter van Dooren second edition New York 2015
- <http://shtetiweb.org/2012/09/22/cjane-politikat-publike>
- <https://lajmi.net/sikur-te-mos-lindte-shkupi-2014-do-te-rilindte-ekonomia-e-maqedonise/>
- <http://www.telegrafi.com/lajme/qeveria-58-milione-euro-te-paligjshme-per-shkupi-2014-79-4584.html>
- Udhëzues për buxhetet, d-r Zhidas Daskalovski m-r ana nikolovska m-r marija risteska 2006 shkup
- Karta evropiane e vetëqeverisjes locale, 1985, Strasburg
- www.tetovo.gov.mk/getart.aspx?aid=39&lan=1
- Udhëzues për qytetarë, Asociacioni MOST, Shkup Esat Stavileci,
- Esat Stavileci, Agni Aliu Struktura dhe metodat e qeverisjes lokale 2003
- Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik, 2006
- <http://verifikimiifakteve.mk/si-manipulohet-ligji-per-qasje-te-lire-deri-te-informatat-me-karakter-publik/>
- Kvarl- Melbye- Tranoy, ,Politika dhe Demokracia, 2006
- Edhe njëherë për Teorinë e Demokracisë, vëll. II. Giovanni Sartori, Tiranë 1992
- James A Paul, NGOs and Global policy-making Global policy forum 2000
- Hyrje në shkencat politike jean-marie denquin
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Veriore numër 08-4642/1 1991
- Bekim Baliqi, politika publike dhe qeverisja 2017
- http://aa.mk/EBStorage/Files/poglavje07_AL.pdf
- Glen Kruz, American Government Botimi 2016
- www.shteti.org

